



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Data/Datum/Date:	30.06.2025
Nr./Br./No:	02/696
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject:	Raporti i përgjithshëm 6-mujor i Punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes


Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Në përputhje me nenin 58, pika "j" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ju paraqesim raportin gjashtëmujor të punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes.

Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të angazhimeve tona gjatë kësaj periudhe dhe shpreh përkushtimin tonë të vazhdueshëm për përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Gjatë këtyre muajve, kemi qenë të angazhuar intensivisht në fusha të ndryshme, gjithmonë në funksion të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Projektet e realizuara përfshijnë sektorët kyç si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, kultura dhe zhvillimi ekonomik, me fokus të veçantë në ngritjen e cilësisë së jetës në komunën tonë.

E vlerësojmë këtë periudhë si dinamike dhe të suksesshme për Komunën e Shtimes. Kjo punë është bazë solide për arritjet e mëtejshme që synojmë, gjithnjë në bashkëpunim me qytetarët tanë. Synimi ynë mbetet i qartë: ndërtimi i një të ardhmeje më të mirë, me projekte të shumta që do të realizojnë në tërësi planifikimin dhe premtimet e qeverisjes sonë.



**Raporti i Përgjithshëm Gjashtëmuor për periudhën
janar – qershor mbi aktivitetet e Ekzekutivit Komunal në Komunën e
Shtimes**

Qershor, 2025

PËRMBAJTJA:

1. Drejtoria e Prokurimit Publik
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
4. Drejtoria për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve
5. Drejtoria Komunale e Arsimit
6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Drejtoria e Shërbimeve Publike
8. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
9. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
10. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
11. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Drejtoria e Prokurimit Publik

Kontratat e nënshkruara gjatë periudhës Janar–Qershor 2025:

	<i>Titulli i aktivitetit të prokurimit</i>	<i>Data nënshkrimit të kontratës</i>	<i>Çmimi i kontratës</i>	<i>Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata</i>
1	Furnizim me dru për Institucionet e Komunës së Shtimës, Kontratë Kornizë 24 muaj	06.01.2025	156,217.50 €	Avni Murtezi BI
2	Ndërtimi i unazës së madhe Petrovë Reçak Belincë, Shtime	16.01.2025	1,489.530.00 €	GOE: Arlindi SHPK dhe ERST BAU SHPK Ferizaj
3	"Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore Lot I" - Kontratë kornizë për 24 muaj" Ritenderim Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët LOT I	18.02.2025	120,000.00 €	N.N.SH. " Vizion Projekt " Prishtinë
4	" Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore Lot II" Kontratë kornizë 24 muaj" Ritenderim Hartimi i projekteve të reja , adaptimeve, renovimeve dhe të tjera Loti -II-	18.02.2025	80,000.00 €	N.N.SH. " Vizion Projekt " Prishtinë
5	Furnizim me banera, flamuj, shtiza korniza me mbajtese për piktura (Vlerë Minimale)	11.03.2025	898.00 €	STAR GRAF SH.P.K
6	Shërbimet e Informimit Publik, Procedurë e Negociuar	12.03.2025	2,993.00 €	Radio Zëri i Shtimës
7	Furnizim me kuzhinë për SHKSH-në në Shtime	14.03.2025	1,170.00 €	BMS SOLUTIONS L.L.C
8	Transporti për gara të nxënësve në territorin e Kosovës (Vlerë Minimale)	15.03.2025	498.00 €	GONI COM SH.P.K SHTIME PETROVË
9	Furnizim me buketa lulesh dhe kurora	17.03.2025	2,430.00 €	LULISHTJA LABI-A Prishtinë
10	Rregullimi i seg të rrugëve dhe ndriçimit: Kanalizim dhe asfaltim në Rr."Smajl Gorani ", trotuar në Rr. "Ibrahim Rugova", Rr." Emini - (Punë shtes)	19.03.2025	6,658.00 €	AMAZON HOLDING SH.P.K
11	Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Shtime (Punë Shtesë)	01.04.2025	1,732.50 €	MEGRANT ING SH.P.K., Prishtinë
12	Blerja e paisjeve speciale mjekësore	01.04.2025	7,991.50 €	MATKOS PHARM SH.P.K., Prishtinë
13	Lidhja e librave për shërbimin e Ofiqarisë - Administrata Komunale Ritenderim (Vlerë Minimale)	03.04.2025	499.00 €	D.P.T,"Libri Tahir Sinani Shtime

14	Shërbime të veçanta - Përkthyes i dokumentave zyrtare (Shqip - Serbisht)	03.04.2025	7,110.00 €	Ibrahim Demiri Reçak
15	Rregullimi i rrugëve dhe trotuarëve - Trotuarë në Rr."Ulqini", seg i Rr."Jashari", vazhdimi i trotuarit për Muzeqinë- (Punë Shtesë)	07.04.2025	7,920.00 €	EUROLINDI SH.P.K., ARLINDI SHPK,FERIZAJ
16	Rregullimi i rrugëve dhe ndriçimit në Shtime Rr. Sefë Kosharja , seg i Rr. Sami Frashëri, Rr.Enver Gashi, Rr.Sahide Metushi,rivitalizimi i Rr.2 Korriku (Punë Shtesë)	07.04.2025	9,684.00 €	EUROLINDI SH.P.K., ARLINDI SHPK,FERIZAJ
17	Furnizim me dhurata për fëmijë, për festat e fundvitit dhe 1 qershori	08.04.2025	1,111.88 €	BMS SOLUTIONS L.L.C VUSHTRR
18	Furnizim me tepih dhe perde për institucionet e Komunës së Shtimës	08.04.2025	3,953.42 €	BMS SOLUTIONS L.L.C
19	Furnizim me drunjë dekorativ dhe lule, për rregullimin e hapsirave publike dhe parqeve në institucionet e Komunës së Shtimës	14.04.2025	12,485.80 €	AGROCOOP GROUP SH.P.K., SHTIME
20	Ndërtimi i parqeve në qytet dhe fshatrat: Gllavicë,Mollopolc,Petrovë, Pjetershticë,Carralevë, Reçak,Godanc, i Poshtëm,L.Pajtimit, Gllavicë	16.04.2025	179,987.00 €	DASHNIM JASHARI BI
21	Shërbimet e Byfësë për Komunën e Shtimës	16.04.2025	6,988.20 €	D.P.H DONATI
22	Furnizim me veshëmbathje	17.04.2025	7,202.50 €	Sankos sh.p.k Kaçanik
23	Rregullimi i tregut të hapur në Qytetin e Shtimës - Faza II- (Punë Shtesë)	17.04.2025	29,789.00 €	Xhemshir Sejdi B.I.;TALA ENGINEERING SH.P.K., GADIME E EPËRME
24	Organizimi i puntorisë- Trajnime	17.04.2025	4,928.00 €	Sherif Salih B.I
25	Furnizim me Oksigjen për QKMF-në Shtime	23.04.2025	1,999.96 €	MESSER MEDICA L.L.C
26	Furnizim me Kompjuter dhe Llaptop-Marrëveshje Kornizë me AQP-në	23.04.2025	20,498.00 €	EGS; Pattern SH.P.K., Prishtinë
27	Furnizim me paisje tjera për institucionet e Komunës së Shtimës	23.04.2025	14,255.25 €	BMS SOLUTIONS L.L.C

28	Shfrytëzimi i Fotokopjeve dhe Printerave me Qera	24.04.2025	9,440.00 €	ILIR - KOSOVA SH.P.K
29	Furnizim me material higjienik për institucionet e Komunës së Shtimës.	24.04.2025	17,413.67 €	PM GROUP SH.P.K
30	Hartimi, kontrollimi dhe monitorimi i testeve sipas lëndëve mësimore në garat komunale të diturisë	24.04.2025	1,491.00 €	PRONET ACADEMY SH.P.K
31	Aktivitetet rekreative sociale dhe rehabilituese për rezidentët në Shtëpinë e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike në Shtime	30.04.2025	3,950.0 0€	HOTEL KROJET SH.P.K
32	Furnizim për aktivitete të ndryshme - (Dita e Mjedisit, Dita e Evropës, 7 Marsi dhe festa të ndryshme: kupa, medalje, pllaketa dhe kopertina).	05.05.2025	1,883.10 €	TROTEX SH.P.K Prishtinë
33	Ndërtimi i Aneksit për Shërbime Rezidenciale	06.05.2025	12,500.00 €	ATSH GROUP SH.P.K ARLINDI SHPK, FERIZAJ
34	Rregullimi i ndriçimit publik në Komunën e Shtimës dhe në fsh, Petrovë, Davidovc, dhe Rr, " Adem Jashari " Shtime	07.05.2025	104,573.50 €	TALA ENGINEERING SH.P.K; EURO RAKETA SH.P.K., PRISHTINË
35	Kontrolli i rrezatimeve të RTG-së dhe matja e dozimetrave të QKMF-së Dr. Vezir Bajrami Shtime(Vlerë Minimale)	08.05.2025	480.00 €	Instituti i mjeksisë së punës Obiliq
36	Ndriçimi në fushat sportive në fshatrat Vojnoc , Davidovc, Carralevë, Pjetershticë,Shtime, Godanc të e Eperm , Gllavicë dhe Zborc	13.05.2025	34,885.00 €	Dashnim Jashari B.I Shtime
37	Rivitalizimi dhe rregullimi i rrugëve në Shtime dhe fshatrat, Godancë, Zborc, Reçak,Lagja e Pajtimit, si dhe disa fshatra LOTI- I-)	15.05.2025	947,346.00 €	Grupi i Operatorve Eskavatori SH.p.k; Best Company SH.P.K Ferizaj - Prishtinë
38	Rivitalizimi dhe rregullimi i rrugëve në Shtime dhe fshatrat Vojnovc,Rashincë,Mollopolc, Petrovë,Davidovc,si dhe disa fshatara LOTI -II-	15.05.2025	949,334.50 €	Dashnim Jashari B.I Shtime
39	Sigurimi i vetures së Kryetarit(Vlerë Minimale)	15.05.2025	988.25 €	SIGMA INTERALBANIAN VIENNAINSURANCE GROUP Prishtinë
40	Aktivitete rehabilituese për Familjet e Dëshmorëve dhe Veteraneven të Luftës	15.05.2025	8,497.50 €	Dashnim Jashari B.I Shtime
41	Mirëmbajtja e objektit të shkollës Emin Duraku në Shtime dhe SHFMU Lasgush Poradeci në Muzeqinë (Vlerë Minimale)	21.05.2025	754.00 €	EKO BULI SH.P.K GODANC- SHITIME
42	Furnizim për zyre për institucionet e Komunës së Shtimes	21.05.2025	20,454.00 €	"INFINIT " SHPK PRISHTINË

43	Asfaltimi i rrugës Llanishtë- Devetak -Shtime	23.05.2025	596,678.00 €	Kastrioti O.P; Dashnim Jashari B.I
44	Mirëmbajtja dhe servisi i aparateve kunder zjarrit	23.05.2025	1,099.00 €	ALBKOS SAFETY SH.P.K Fushë Kosovë
45	Furnizim me pelet për institucionet e Komunës së Shtimës	23.05.2025	42,709.95 €	Bek Fluids L.L.C Fushë Kosovë
46	Mirëmbajtja e varrezave në qytet dhe varrezat e Veteranve , dhe në të gjitha fshatrat e Komunës së Shtimës -kontratë kornizë 12muaj	28.05.2025	45,000.00 €	EURO RAKETA SH.P.K.
47	Furnizim me internet për disa shkolla të Komunës së Shtimës	04.06.2025	1,104.00 €	AE HOLDING L.L.C., GILAN
48	Dezinfektimi, Dezinsektimi, dhe Deratizimi i objekteve institucionale në Komunën e Shtimës	04.06.2025	16,218.34 €	VLERA SH.P.K., EKOLOGJIA SH.P.K SHTIME
49	Rregullimi i Kanaleve Kulluese në Fshatin "Godanc" në Komunën e Shtimës	05.06.2025	498,984.00 €	ILEAA-GR SH.P.K., PRISHTINË
50	Furnizim me material laboratorik Loti -II	11.06.2025	12,967.00 €	"GENIUS KOSOVA" SH.P.K. FERIZAJ
51	Rruga Godanc - Rashincë-Muzeqinë, Shtime - (Punë Shtes)	11.06.2025	88,701.56 €	Linda, Gërllicë, Magj. Ferizaj-Kaçanik, Ferizaj
52	Furnizim me bileta të udhëtimit me aeroplan	17.06.2025	3,000.00 €	" AS TRAVEL CLUB" SH.P.K.,
53	Ndërtimi i Shtratit të Lumit Petrovë, Reçak dhe Belincë	18.06.2025	1,794.790.00 €	Rinesa SH.P.K; LIMIT PROJECT SH.P.K., BAJICË

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Raport Përmbledhës i Kontrollit të Buxhetit

Përshkrimi	Buxhet Aktual	Alokuar	E paalokuar	Aktuali	Zotimet/obligimet e paguara	Bilanci	Parashikimi vjetor	Sufici/Deficit
REGP / CAT / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E	A - E
017 SHITIME	11,040,313.33	7,340,391.83	3,699,921.50	4,626,866.38	1,488,440.56	4,326,010.40	0.00	11,040,313.33
10 BUXHETI	10,180,789.73	6,994,339.73	3,186,450.00	4,468,868.93	1,400,572.66	4,311,541.26	0.00	10,180,789.73
11 PAGA DHE SHITESA	6,222,744.73	3,036,294.73	3,186,450.00	2,531,189.26	0.00	3,691,555.47	0.00	6,222,744.73
13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,367,038.00	1,367,038.00	0.00	502,710.09	549,540.08	254,787.83	0.00	1,367,038.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	230,000.00	230,000.00	0.00	104,228.84	12,361.86	113,409.30	0.00	230,000.00
20 SUBVENCIÓN DHE TRANSFERE	230,000.00	230,000.00	0.00	121,633.45	92,764.00	15,602.55	0.00	230,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	2,130,998.00	2,130,998.00	0.00	1,148,905.29	745,906.61	236,186.10	0.00	2,130,998.00
21 TË HYRAT VETANAKE	858,258.00	344,796.50	513,471.50	167,189.46	87,974.00	613,104.56	0.00	858,258.00
11 PAGA DHE SHITESA	38,000.00	18,806.40	19,193.60	0.00	0.00	38,000.00	0.00	38,000.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	134,962.00	55,966.92	78,996.08	15,249.80	25,291.00	94,421.20	0.00	134,962.00
20 SUBVENCIÓN DHE TRANSFERE	270,000.00	140,761.69	129,238.31	85,852.69	37,500.00	146,647.31	0.00	270,000.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	415,296.00	129,252.49	286,043.51	56,086.96	25,083.00	334,126.04	0.00	415,296.00
31 GRANTI I DONACIONEVË TË BRENDSHMË	1,202.90	1,202.90	0.00	0.00	0.00	1,202.90	0.00	1,202.90
11 PAGA DHE SHITESA	855.90	855.90	0.00	0.00	0.00	855.90	0.00	855.90
13 MALLRA DHE SHËRBIME	347.00	347.00	0.00	0.00	0.00	347.00	0.00	347.00
61 QEVERIA ZVËCRANË	71.70	71.70	0.00	0.00	0.00	71.70	0.00	71.70
30 PASURITË JOFINANCIARE	71.70	71.70	0.00	0.00	0.00	71.70	0.00	71.70
Totali i përgjithshëm	11,040,313.33	7,340,391.83	3,699,921.50	4,626,866.38	1,488,440.56	4,326,010.40	0.00	11,040,313.33

Të hyrat buxhetore të Komunës së Shtimes të alokuara për vitin fiskal 2025 janë:

- Granti qeveritar – 9,918,922.00 €
- Të hyrat tjera në bazë të vendimit të Qeverisë të datës 05.06.2025 për rritjen e pagave prej muajit korrik 2025 në shumën prej 261,858.73 €
- Të hyrat vetanake 858,258.00 €
- Të hyrat e bartura nga viti i kaluar 266,448.06 €
- Granti i donatorëve të brendshëm 1,202.90 €
- Mjetet e bartura nga Granti i performancës 71.70 €

Buxheti në total për vitin 2025: 11,306,761.39 €

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Gjatë muajit janar 2025 është hapur thirrja për aplikim për grante nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, përkatësisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për Masën 1 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” dhe Masën 3 “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore”, ku gjatë kësaj periudhe një numër i konsiderueshëm i fermerëve kanë marrë informata për aplikim, aplikuesit janë pajisur me numrin identifikues të fermerit, aneksin dhe është bërë digjitalizimi i parcelës ku është planifikuar të bëhet investimi në rast të përfitimit të grantit.

Po ashtu, me datë 15 janar 2025 është hapur thirrja për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë; për viça për majmëri dhe për zogj për majmëri (brojlerët).

Gjatë kësaj kohe kanë aplikuar:

- **9 fermerë**, në total **134 viça** për majmëri dhe
- **13 fermerë**, për cilësi të **qumështit** me rreth **170,731 litra qumësht**.

Gjithashtu, në bashkëpunim me MBPZHR dhe përfaqësuesit e Shërbimeve Këshillimore dhe KDC si implementuese e projektit të shërbimeve këshillimore, kemi organizuar disa trajnime për fermerët e komunës tonë me tema të ndryshme sipas kërkesave të fermerëve:

- **Pemëtari:** Krasitja dhe trajtimi i pemëve
- **Lavërtari:** Mbjelljet pranverore
- **Kultivuesit e perimeve në serra:** Kultivimi i perimeve në serra
- **Bletari:** Vjelja dhe ruajtja e mjaltit.

Më datë 3 prill 2025, pas hapjes së thirrjes në Programin për Pagesa Direkte për vitin 2025 nga MBPZHR, përkatësisht AZHB, thirrje e cila ka zgjatur deri më 19 maj 2025, është bërë pranimi i aplikacioneve të fermerëve dhe gjithsej kanë aplikuar 579 fermerë.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka hartuar planin për mbjelljet pranverore për vitin 2025 dhe në përfundim të aplikimit për subvencione ka nxjerrë edhe raportin e realizimit të mbjelljeve pranverore për vitin 2025.

Kulturat e mbjella pranverore për vitin 2025:

Nr.	Kultura	Sipërfaqet planifikuara/ha	Sipërfaqet e realizuara / ha
1	Misër kokërr	900	860
2	Misër me fasule	35	40
3	Misër i gjelbërt	20	17
4	Elb	10	8

5	Tërrëshër	20	16
6	Bimë furragjere	30	20
7	Bimë industriale	0	0
8	Perime në serra	6	5
9	Perime në fushë të hapur	60	71
10	Patate	12	5.50
11	Fasule monokulturë	45	50
Gjithsejt			1092.5 ha

Sip. Grurit	Sip. Misër	Tërrshër	Elbi	Arra	Fasule	Kunguj	Patate	Speca	
1646,58	917,72	15,15	8,09	15,78	50,34	25,10	5,59	25,61	
Domate	Marullë	Lakër	Perime në serra	Molla	Lajthi	Dardha	Kumbulla	Manaferra	Mjedra
0.00	2,47	21,77	5,12	28,14	10,45	4,97	24,70	1.00	0.70
Dredhëza	Qepë	Shalqin	Pjepër	Lopë qumështore	Viqa	Dele	Dhi	Pula	Bletë
0.78	10,72	3.40	5,91	567 copë	0 copë	1920 copë	555 copë	494	593

Sipërfaqja e përgjithshme e të mbjellave për këtë vit është: **2,830.09 ha**, dhe dallimi në mes vitit 2024 dhe 2025 është se këtë vit ka rritje të të mbjellave të përgjithshme me rreth **52.66 ha**.

Përgjegjësi për Bujqësi ka marrë pjesë në komisionin për vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore, ku së bashku me anëtarët e tjerë të këtij komisioni janë bërë vlerësimet e dëmeve nga secila kërkesë e parashtruar nga palët.

Është duke u implementuar projekti për trajtimin e qenve endacakë, ku me këtë projekt janë paraparë të trajtohen 100 qen endacakë. Deri më tani janë trajtuar 66 qen endacakë dhe është bërë kastrimi, dehelmetizimi dhe matrikulimi i tyre.

Gjatë kësaj periudhe kohore, janar–qershor 2025, kemi pranuar dhe shqyrtuar 6 kërkesa të palëve dhe 5 prej tyre kanë qenë për shndërrim toke, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, dhe të gjitha janë aprovuar. Shuma e inkasuar nga shndërrimi i tokës bujqësore në jo-bujqësore arrin **22,295.00€**.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka hapur thirrjen për subvencionimin e serrave me numër të protokollit 12/13 e datës 29.04.2025 dhe ka qëndruar e hapur deri më 13 maj. Vlera e përgjithshme e këtij subvencioni është: **37,500.00 €**. Kemi pranuar 187 aplikues dhe pas formimit të komisionit për shpërndarjen e serrave, i njëjti ka filluar në terren punën.

Drejtoria për Inovacion dhe Zhvillim të Projekteve

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecurisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Gjatë kësaj periudhe, puna jonë është fokusuar në forcimin e bashkëpunimeve institucionale, zbatimin e planeve strategjike dhe promovimin e inovacionit në Komunën e Shtimes. Qendra e Inovacionit, në bashkëpunim me “Flutura Academy”, po krijon hapësira për të rinjtë ku ideja zhvillohet, sfidat zgjidhen në mënyrë inovative dhe ndërmarrësia kultivohet si vlerë thelbësore.

Në qendër të fokusit tonë është jo vetëm zhvillimi i aftësive teknologjike, por edhe mbrojtja e interesave dhe e të drejtave të nxënësve për të menduar lirshëm, komunikuar dhe eksploruar.

Gjatë kësaj periudhe kemi mbajtur takime të rregullta për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit, si dhe vizita në terren për të parë nga afër sesi mësimdhënësit po aplikojnë metodat e reja mësimore.

Një hap i rëndësishëm ishte nënshkrimi i marrëveshjes së re më 13 maj 2025, që rregullon detajisht bashkëpunimin mes Komunës dhe “Flutura Academy” për përdorimin e hapësirave komunale në shërbim të edukimit të të rinjve tanë.

Statistikat kryesore:

Në fillim të vitit akademik janë regjistruar:

- **127** nxënës në programet e programimit
- **119** nxënës në kurset e gjuhës angleze
- **53** nxënës në dizajn grafik

Përfshirja gjinore:

- Në programet e programimit 45 femra, 51 meshkuj;
- Në anglisht 56 femra, 40 meshkuj;
- Në dizajn grafik 21 femra, 10 meshkuj.

Nr.	Lloji i Kursit	Nr.Nxënësve	Mosha	Orë/Javë	Orë/Muaj	Orë gjithsej	Kësti Mujor	Financuar nga Komuna
1	Gjuhë Angleze	35	8-18	4	16	64	30€	✓
2	Programim Bazik Programim i Avansuar	18	15-18	4	16	64	30€	✓
3	Dizajn Grafik Bazik	7	12-14	4	16	64	30€	✓

	Dizajn Grafik i Avansuar							
--	--------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

Aktivitetet jashtëkurrikulare si klubet e leximit, debatit, hackathon-i, filmave, lojërave dhe krijimtarisë kanë në total në të gjitha programet janë përfshirë mbi 300 nxënës.

Drejtoria Komunale e Arsimit

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecuresisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Në kuadër të dinamikës së punëve për gjashtëmujorin e parë për vitin 2025, Drejtoria Komunale e Arsimit ka realizuar me sukses planin e punës për këtë vit kalendarik.

Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet, punët dhe angazhimet e Drejtorisë Komunale për Arsim, nga 1 janari, deri në fund të muajit Qershor 2025.

Duke u bazuar në Kalendarin Zyrtar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin shkollor 2024/2025, zhvillimi i procesit mësimor në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Shtimes është realizuar sipas këtij orari:

- Gjysmëvjetori i dytë ka filluar më **8 janar 2025** për të gjitha nivelet shkollore.
- Më **15 maj 2025** ka përfunduar viti mësimor për nxënësit e klasës së **dymbëdhjetë (XII)** – maturantët.
- Më **5 qershor 2025** ka përfunduar viti mësimor për klasat **IX, X dhe XI**.
- Më **23 qershor 2025** përfundon viti mësimor për **parafillorët dhe klasat I – VIII**.

Realizimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare nga institucionet shkollore

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Kalendarin e vitit shkollor 2024/2025 dhe Udhëzimin Administrativ për Aktivitete Jashtëshkollore nr. 02/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të gjitha institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Shtimes kanë organizuar aktivitete të ndryshme edukative me nxënës, për shënimin dhe kremtimin dinjitoz të datave me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës.

- Për Ditën Përkujtimore kushtuar 26-vjetorit të Masakrës së Reçakut, më **14 janar 2025** në të gjitha institucionet arsimore të komunës sonë, ora e parë mësimore i është kushtuar 15 janarit të vitit 1999, ku forcat policore dhe ushtarake serbe ekzekutuan 42 civilë të pafajshëm. Po ashtu, gjatë kësaj ore mësimore është ligjëruar edhe për rëndësinë historike që ka pasur kjo ngjarje e dhimbshme nga e cila kanë pasuar bombardimet 78 ditëshe ndaj forcave kriminale serbe nga Aleanca Veriatlantike NATO.
- Nga data **12 – 17. 2. 2025**, nxënësit e komunës së Shtimes (SHFMU “Bajram Curri”-Petrovë dhe SHFMU “Lasgush Poradeci”-Muzeqinë), kanë marrë pjesë në projektin “Drejt Malit”, një aktivitet që synon promovimin e sportit dhe aventurës. Në këtë projekt morën pjesë 40 nxënës nga këto dy shkollat e lartpërmendura, të cilët sfiduan veten në ngjitje malore dhe gara të ndryshme, duke treguar aftësi të jashtëzakonshme fizike dhe mendore. Përkushtimi dhe energjia e tyre u shpërblyen me medalje dhe mirënjohje, duke dëshmuar se puna e palodhur dhe bashkëpunimi sjellin sukses. Ky program mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe realizohet nga Federata e Sportit Shkollor në bashkëpunim me Federatën Skitare të Kosovës dhe Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Projekti është pjesë e përpjekjeve për promovimin e Parkut Kombëtar “Sharri” dhe sporteve malore.
- Më **20. 2. 2025** shtatë nxënës të ShMU “Emin Duraku” kanë marrë pjesë në Garën Republikane të Shahut në Gjakovë.
- Për nder të përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, ora e parë e mësimit në të gjitha shkollat e komunës sonë, i është kushtuar kësaj dite të rëndësishme së veçantë për popullin tonë. Me këtë rast, më **14 shkurt 2025**, në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë janë organizuar programe festive për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, si: Programe kulturore dhe

festive, orë të mësimi të veçanta në lëndën e historisë, gjuhë dhe letërsi shqipe, edukatë muzikore, edukatë figurative etj.

- Në kuadër të projektit të Kryqit të Kuq për "Promovimin e vlerave humane", më 28 shkurt 2025 nxënësit e IAAP-së shënuan Ditën e Karrocës me aktivitete domethënëse. Në këtë kuadër, është organizuar në rrugën "Tahir Sinani" të qytetit një marsh sensibilizues dhe janë krijuar tri parkingje të dedikuara për personat me nevoja të veçanta, duke dhënë një shembull konkret të përfshirjes dhe solidaritetit.
- Me rastin e përkujtimit të përvjetorit të Epopesë së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), më **5 mars 2025** të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë, orën e parë të mësimi ia kanë kushtuar rëndësisë së Epopesë së UÇK-së, për krijimin e shtetësisë së Kosovës. Ndërkaq, më **6 dhe 7 mars 2025**, bazuar në Udhëzimin Administrativ për Aktivitete Jashtëshkollore (UA-02/2016), janë organizuar aktivitete me nxënës në institucionet tona arsimore, ku përfshihen aktivitetet e lira si: Arte të bukura, fotografi, ese, aktivitete sportive etj.
- Më **6 mars 2025**, nxënësit e shkollës fillore "Emin Duraku" kanë shkëlqyer në garën parafinale të raundit të dytë në robotikë të organizuar për ekipet e ciklit I-V nga Kosova Makers League Open 2024-25. Ekipet **#Edu5un** dhe **#Edu5tar5** në këtë sfidë treguan performancë të jashtëzakonshme, duke zënë vendin e tretë dhe të katërt në nivel republike. Mentorët e këtyre dy ekipeve ishin mësimdhënësit: Florinda Hoxha dhe Bekim Krasniqi.
- Më **7 mars 2025** në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes është organizuar ceremonia festive me rastin e Ditës së Mësuesit. Me këtë rast, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpërblyer me mirënjohje 11 mësimdhënësit të dalluar për kontributin e tyre të çmuar në procesin edukativo- arsimor, 8 veteranë të arsimit dhe 6 ish-mësimdhënësit me mirënjohje post-mortem. Ky vlerësim u bë në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për punën e palodhshme të mësuesve në edukimin e gjeneratave të reja dhe të shumë brezave tjerë. Për nder të kësaj dite, Drejtoria Komunale e Arsimit për Çmimin "Shaban Jashari" në MASHTI ka nominuar mësimdhënësin e matematikës nga ShMU "Emin Duraku", Sokol Aliu, i cili është shpërblyer me mirënjohje për kontribut të veçantë në fushën e arsimit dhe edukimit.
- Për nder të Epopesë së UÇK-së dhe 7 Marsit, Ditës së Mësuesit nxënësit e IAAP-së kanë vizituar "Reporting House" në Prishtinë, një muze që ofron një pasqyrë të thelluar mbi rolin e medias gjatë periudhës së Luftës së Kosovës (1989-1999), si dhe ndikimin e saj në formimin e mendimit publik. Gjatë kësaj vizite, nxënësit janë njoftuar me ngjarjet historike të periudhës së luftës dhe si gazetarët dhe mediat luajtën një rol të rëndësishëm në dokumentimin dhe raportimin e ngjarjeve që ndodhën gjatë asaj kohe. Ata patën mundësinë të dëgjonin histori dhe eksperiencën nga ekspertë të fushës, të cilët ndanë pamje të rëndësishme dhe emocionale nga periudha e luftës. Një pjesë e rëndësishme e ekspozitës ishin artefaktet e ndryshme nga periudha e Luftës së Kosovës, të cilat shërbyen si dëshmi të vuajtjeve, sakrificave dhe qëndresës së popullit të Kosovës gjatë kësaj periudhe të vështirë. Nxënësit kishin mundësinë të shihnin fotografi, dokumente dhe objekte që tregojnë historinë e njerëzve të zakonshëm që luftuan për lirinë e Kosovës. Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për nxënësit që të mësojnë jo vetëm për historinë e Kosovës, por edhe për rëndësinë e medias si një mjet për të dokumentuar dhe ruajtur kujtimet e rëndësishme historike.
- Më **24 prill 2025** në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Shtime është mbajtur festivali kulturor "Mozaiku Kulturor", organizuar në kuadër të projektit "Promovimi i Vlerave Humane", të mbështetur nga Kryqi i Kuq i Kosovës-Dega në Shtime. Në këtë festival kanë marrë pjesë: Nxënësit e IAAP-së, Gjimnazi "Naim Frashëri", Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Ilirida", Grupi nga Komuniteti Ashkali, Shkolla Fillore "Emin Duraku", Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani" dhe këngëtari Deon Vuniqi.

- Me Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Komunës së Shtimes dhe AMJ Kosova më 24. 4. 2025, në oborrin e IP “Albiona Asllani” në Shtime, më **26 prill 2025** është bërë mbjellja e 26 fidanëve. Ky aktivitet përkon me 22 Prillin - Ditën e Tokës dhe është një mundësi e shkëlqyer për të ndihmuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Mbjellja e fidanëve ka një rëndësi të veçantë, pasi fidanët janë pemë që kontribuojnë shumë në pastrimin e ajrit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ato mbajnë balancën e klimës, duke absorbuar dioksidin e karbonit dhe duke ofruar oksigjen të pastër për ne. Gjithashtu, ato ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës dhe mbështesin jetesën e shumëllojshme të faunës. Aktivitetet e tilla, si mbjellja e fidanëve, jo vetëm që kontribuojnë në pasurimin e peizazhit, por gjithashtu i ndihmojnë komunitetit të ndërgjegjësohen për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës. Mbjellja e fidanëve është një hap i vogël, por i rëndësishëm, që na ndihmon të krijojmë një të ardhme më të pastër dhe të qëndrueshme për brezat që do të vijnë. Aktiviteti si ky, është realizuar në të gjitha institucionet arsimore të komunës sonë dhe janë një hap i madh për t’u bashkuar dhe për të vepruar për një botë më të shëndetshme.
- Në ambientet e Shkollës së Mesme të Ulët "Emin Duraku" në Shtime, më **8 maj 2025** është organizuar aktiviteti tashmë tradicional "Sofra shkollore", një nismë kjo që ka për qëllim bashkëpunimin ndërmjet nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve, por edhe ndihmën konkrete për shkollën. Nxënësit, me përkushtim të madh, kishin përgatitur ushqime të ndryshme tradicionale, të cilat u shërbyen për vizitorët dhe mysafirët në këmbim të donacioneve. Të hollat e mbledhura (471.25 euro) nga ky aktivitet do të përdoren për nevojat e shkollës, duke e kthyer kështu këtë iniciativë në një shembull të mirë të angazhimit. Në fund të këtij aktiviteti, nxënësit e shkollës "Emin Duraku" përgatitën edhe një program kulturo-artistik.
- Meqenëse Festa e Abetares është një ngjarje e veçantë në jetën e secilit nxënës të klasës së parë, më **16 maj 2025** shkollat e komunës sonë, kanë shënuar këtë ditë festive me karakter mbarëkombëtar. Në shënimin e kësaj dite nxënësit e klasave të para shprehën aftësitë e tyre të të mësuarit të alfabetit të gjuhës shqipe.
- Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 02/2016 për Aktivitete Jashtëshkollore, më **17 maj 2025**, në restorantin “BA Palace” në Davidovc është organizuar Mbrëmja e Maturës me rreth 300 nxënës maturan të Gjimnazit “Naim Frashëri” dhe Institucionit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Shtime.
- Përmes programit “Drejt Malit” është organizuar ecja në natyrë, më **22 maj 2025** për 70 nxënës të shkollave fituese në garat komunale në sport (ShFMU “Bajram Curri”, ShMU “Emin Duraku” dhe ShFMU “Lasgush Poroadeci”). Shtegu i ecjes ishte 5.5 kilometra nga fshati Jezerc duke kaluar te vendi i quajtur “Gurra e Kadisë” dhe “Gurrec”-it. Ky aktivitet ka synuar të promovojë aktivitetin fizik në natyrë, edukimin mjedisor dhe zhvillimin social të nxënësve në një atmosferë motivuese dhe gjithëpërfshirëse. Programi “Drejt Malit” është mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe është realizuar nga Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me shoqatat komunale të sportit shkollor.
- Më **26 maj 2025** në aktivitetin Karvani Shëndetësor “Përshëndetje”, të organizuar nga Komuna e Shtimes – konkretisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – në bashkëpunim me projektin (Accessible Quality Healthcare), Fondacionin Kosovar për Popullsi (KOPF) dhe QKMF “Dr.Vezir Bajrami” në Shtime, morën pjesë edhe nxënësit e IAAP-së nga klasat e 10-ta dhe të 11-ta, drejtimi Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë. Disa nga aktivitetet e realizuara nga nxënësit tanë ishin:
 - Llogaritja e indeksit të masës trupore (BMI),
 - Matja e tensionit arterial,
 - Matja e nivelit të glukozës në gjak (glikemisë),
 - Interpretimi i vlerave të përfituara,
 - Këshillimi për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve shëndetësore,

- Vetëdijesimi për rëndësinë e aktivitetit fizik, efektet e dëmshme të duhanit dhe alkoolit, mbipeshën dhe ushqimin e shëndetshëm.
- Më **26 maj 2025** është mbajtur Dita e Gjimnazit “Naim Frashëri” dhe është organizuar Ceremonia e Diplomimit të Maturantëve.
- Më **31 maj 2025**, në ShFMU “Hasan Prishtina” është organizuar turniri tradicional në futboll të vogël kushtuar futbollistit, Qerim Gashi nga Godanci.
- Në ambientet e Shtëpisë së Kulturës në Shtime, më **9 qershor 2025** nga ShMU “Emin Duraku” është mbajtur ceremonia zyrtare e përfundimit të klasës së nëntë. Me këtë rast është organizuar një program simbolik për të shënuar këtë moment të rëndësishëm në rrugëtimin arsimor të nxënësve të kësaj shkolle.
- Për nder të 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Shtimes, më **12 qershor 2025** Drejtoria Komunale e Arsimit, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime ka organizuar ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve dhe mirënjohjeve për shkollat dhe nxënësit fitues të vendeve të para, dyta dhe treta. Me këtë rast, është mbajtur edhe një program i pasur kulturor për shënimin e kësaj dite festive.
- Në kuadër të Kalendarit të Sportit Shkollor në institucionet tona arsimore janë zhvilluar garat në lojën e shahut, pingpongut, hendbollit, volejbollit etj.

Shëtitjet njëditore nga nxënësit e klasave të nënta (IX)

Në fund të muajit maj dhe në fillim të muajit qershor 2025, për nxënësit e shtatë shkollave të mesme të ulëta, respektivisht për nxënësit e klasave të nënta (IX) është organizuar shëtitje njëditore nëpër territorin e Republikës së Kosovës. Zakonisht gjatë këtyre shëtitjeve, vizitohet qyteti i Prizrenit, gjegjësisht ndërtesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kalaja e Prizrenit etj, mandej vizitohet vendburimi i lumit Drin i Bardhë që ka rrjedhën rrëzë malit të Rusolisë nga gurra e shpellës së Radavcit (Pejë), në 586 metra lartësi mbidetare, i cili përndryshe njihet si lumi më i madh i gjeografisë shqiptare. Vizitohet Prekazi legjendar prej ku ka nisur liria e Kosovës, Shpella e Mermertë e Gadimes, një nga vlerat më të bukura dhe më të rralla speleologjike në Evropë, vizitohen shpatijet e Sharrit siç është Prevala dhe Brezovica piktoreske, mandej Ujëvara e Mirushës në fshatin Llapçevë (Malishevë), Burimi i Istogut me rrjedhje prej 2,500 litra ujë në sekondë, i cili buron në lartësi mbidetare 480 metra si dhe vendbanime tjera turistike.

Organizimi i Piknikut për Nxënës Filloristë (I-V)

Për nxënësit e shkollave fillore (I – V), realizohet pikniku dy herë në vit, në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor. Dita e Piknikut është ditë mësimi dhe organizohet brenda territorit të komunës së Shtimes, zakonisht në fshatin Llanisht. Meqenëse territori i komunës sonë është i vogël, me miratim paraprak të prindërve të nxënësve janë lejuar të vizitojnë Parkun Nacional “Gërmia” në Prishtinë, fshatin piktoresk të Jezercit (Ferizaj) dhe vende tjera.

Shënimi i Ditëve të Shkollave

Për çdo vit, shkollat e komunës së Shtimes, shënojnë ditat e tyre të shkollave. Programi i tyre ka përmbytur pjesë të zgjedhura artistike dhe profesionale, të cilin e kanë përgatitur mësimdhënësit dhe nxënësit. Ditat e shkollave në këtë vit shkollor janë shënuar më:

- 20 Maj – Dita e ShFMU “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë;
- 26 Maj – Dita e Gjinnazit “Naim Frashëri” në Shtime;
- 29 Maj – Dita e ShFMU “Idriz Ajeti” në Pjetërshticë;
- 30 Maj – Dita e ShFMU “Bajram Curri” në Petrovë;
- 5 Qershor – Dita e ShFMU “Hasan Prishtina” në Godanc;
- 10 Qershor – Dita e ShF “Emin Duraku” në Shtime;
- 10 Qershor – Dita e ShMU “Emin Duraku” në Shtime;
- 11 Qershor – Dita e ShFMU “Skënderbeu” në Reçak;
- 13 Qershor – Dita e ShFMU “Abdullah Shabani” në Carralevë.

Publikimi i revistave shkollore

Gjatë këtij viti shkollor, institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë kanë publikuar revistat e tyre shkollore, ku janë trajtuar tema të ndryshme arsimore, pedagogjike, histori, art, poezi, pikturë etj.

1. Revista shkollore “**Filizat**” – ShFMU “Skënderbeu”, 24 faqe, e cila është publikuar me rastin e Ditës së Shkollës;
2. Revista shkollore “**Zenit**” – Gjinnazi “Naim Frashëri”, me 110 faqe. Këtë vit ka realizuar numrin e tetë me radhë dhe është publikuar më 26 maj për nder të Ditës së Shkollës.

Kontrollimi sistematik i nxënësve dhe vaksinimi i tyre

Në kuadër të planit për promovimin dhe ruajtjen e shëndetit të fëmijëve, më **15 maj 2025** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” në Shtime në koordinim me Drejtorinë Komonale të Arsimit ka organizuar vizitat sistematike shëndetësore nëpër institucione arsimore të komunës sonë. Aktiviteti ka nisur në Shkollën Filllore “Emin Duraku” në Shtime duke përfshirë fëmijët e grup-moshës parashkollore dhe të nxënësve të klasave të para.

Vizitat janë realizuar nga një ekip profesional shëndetësor i përbërë nga mjekë dhe infermierë, të cilët kryejnë kontrollat të plota shëndetësore. Ato kanë përfshirë matjen e peshës dhe gjatësisë, kontrollin e shikimit dhe dëgjimit, vlerësimin psiko-motorik, kontrollin oral sipërfaqësor, këshillimin për higjienën personale dhe orale, si dhe kontrollin e vaksinave sipas kalendarit të imunizimit. Po ashtu, nxënësit janë rekomanduar për ushqyerje të shëndetshme dhe aktivitete fizike.

Qëllimi kryesor i këtyre vizitave është identifikimi i hershëm i çdo çrregullimi shëndetësor, ofrimi i ndërhyrjeve të menjëhershme dhe edukimi shëndetësor i fëmijëve, familjeve dhe stafit arsimor.

Me këtë iniciativë, synohet të promovohet një zhvillim i shëndetshëm fizik, emocional dhe social i fëmijëve, duke parandaluar përkeqësimin e problemeve të mundshme dhe duke fuqizuar rolin e shkollave në ruajtjen e shëndetit publik.

Më **19 dhe 21 shkurt 2025** është bërë vaksinimi i nxënësve të klasave të XII-ta në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësisit Profesional në Shtime me vaksinën kundër tetanusit dhe difterisë (dT). Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim me QKMF.”Dr.Vezir Bajrami” Shtime dhe ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të nxënësve tanë.

Trajnime për stafin arsimor dhe ligjërata vetëdijesuese për nxënës

Më **1 shkurt 2025** Kryqi i Kuq i Kosovës ka organizuar një trajnim dy-ditor për Desiminorë, si pjesë e projektit “Promovimi i Vlerave Humane” (PVH). Qëllimi i projektit: Përfshirja e të rinjve nga përkatësi të ndryshme etnike në projekte të përbashkëta që promovojnë mirëkuptimin, tolerancën, paqen, kulturën e dialogut dhe jo dhunën.

Përfitimet për të rinjtë: Mundësi për të punuar në grupe dhe përmirësim i aftësive komunikuese, zhvillimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve shoqërore. frymëzim për ndryshime personale dhe angazhim në aktivitete të dobishme, certifikim dhe letra rekomanduese për angazhimet e tyre.

Më **15 mars 2025** në Gjimnazin “Naim Frashëri” ka nisur trajnimi i radhës për "Aplikimin e programeve kompjuterike në mësimdhënie", të organizuar nga SBASHK-u. Trajnimi në fjalë është realizuar për mësimdhënësit e Gjimnazit “Naim Frashëri” dhe Institucionit të Arsimit dhe Aftësisit Profesional në Shtime.

Më **18-19 mars 2025** nga Policia e Kosovës, në ShMU “Emin Duraku” në Shtime është mbajtur ligjërata me temën "Pasojat e përdorimit të narkotikëve" me klasat VII-IX.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Kompanisë HSK dhe IAAP-së, më **23 prill 2025** ka filluar trajnimi i nxënësve të klasave të 12-ta në fushën “Siguria dhe Shëndeti në Punë”, i cili ka përfshirë pesë module kryesore:

1. Siguria dhe shëndeti në punë,
2. Dhënia e ndihmës së parë,
3. Ruajtja e ambientit,
4. Marrja e masave për parandalimin e zjarrit,
5. Masat për parandalimin e dukurive negative.

Pas përfundimit të trajnimit, nxënësit janë pajisur me certifikata zyrtare, që do t’u shërbejnë si një avantazh i rëndësishëm për integrimin në tregun e punës. Ky bashkëpunim përfaqëson një model të shkëlqyer të lidhjes mes shkollës dhe sektorit të biznesit, duke vendosur bazat për një përgatitje më të mirë profesionale të nxënësve tanë.

Më **14 maj 2025** nga DKA dhe Shoqata Profesionale e Informaticientëve të Kosovës (ShPIK), në IAAP në Shtime kanë organizuar trajnimi praktik për Code.org për përgatitjen e mësimdhënësve që do të zgjedhin lëndën mësimore për kodim për nxënës të niveleve 1 – 5, në shtator të këtij viti të ri shkollor. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë gjithsej: 20 mësimdhënës të të gjitha shkollave fillore të komunës sonë.

Më **26 dhe 27 maj 2025** nga Policia e Kosovës në ShFMU “Bajram Curri”, me klasat e VII dhe VIII është mbajtur ligjërata me temën: "Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm”. E njëjta ligjëratë është mbajtur, më **28 maj 2025** me nxënësit e ShFMU “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë.

Më **6 maj 2025** nga OSBE është prezantuar programi “Girl’s talks” (Biseda e vajzave), në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime, ku kanë marrë pjesë 30 nxënës (vajzave).

Nga data **21 – 25 prill 2025** në të gjitha shkollat e mesme të ulëta për nxënës e klasave të nënta është organizuar “Java e dyerve të hapura”, ku janë informuar për drejtimit dhe profilet e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional si dhe regjistrim në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime.

Nga data **22 – 25 prill 2025** në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime është organizuar aktiviteti me nxënës e klasave të dymbëdhjeta për orientimin e tyre profesional për regjistrim nëpër universitetet e Republikës së Kosovës.

Garat komunale, regjionale dhe nacionale

Më **18 shkurt 2025**, u mbajtën garat finale të “Spelling Bee”, të organizuara nga Hamilton House. Në këto gara, pjesëmarrës ishin edhe nxënës nga shkolla jonë IAAP-Shtime, ku ndër ta, Andi Çerkini dhe Izet Maliqi, shfaqën një performancë të shkëlqyer dhe arritën të kualifikohen për të vazhduar garën në nivel shtetëror.

Më **7 mars 2025**, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, u mbajt me sukses aktiviteti i organizuar nga OJQ “Link” për nder të Ditës së Mësuesit. Ky aktivitet përfshiu testimin e nxënësve nga klasat e pesta në tri lëndë, si dhe shfaqjen e një dokumentari mbi arsimin në vitet ’90. Pas përfundimit të testimit, u shpallën rezultatet dhe tre shkollat që dolën më të suksesshme ishin:

Shkolla "Lasgush Poradeci" – Vendi i parë (I)

Shkolla "Bajram Curri" – Vendi i dytë (II)

Shkolla "Abdullah Shabani" – Vendi i tretë (III)

Më **11. 3. 2025** është bërë organizimi Olimpiadës në nivel shkolle në gjuhën shqipe me nxënës e kl. 9 – ta të shtatë shkollave të mesme të ulëta. Organizuar nga Ministritë e Arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës, ky organizim synon nxitjen e nxënësve për mësimin e gjuhës amtare, nxjerrjen në pah të prirjeve dhe talenteve në lëndën e gjuhës shqipe si dhe promovimin e vlerave të gjuhës tonë kombëtare.

Më **15 mars 2025** nën organizimin e Hamilton House, Pema dhe Libraria Buzuku në Prishtinë (Në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë), është mbajtur gara në gjuhën angleze “Spelling Bee”, ku morën pjesë edhe nxënës tanë nga shkolla “Idriz Ajeti”, “Bajram Curri” dhe “Emin Duraku”.

Më **20. 3. 2025**, trembëdhjetë nxënës fitues të shkollave të mesme të ulëta, kanë sfiduar dijen e tyre në Olimpiadën e gjuhës shqipe në nivel Komune, të mbajtur në Bibliotekën e Qytetit në Shtime.

Më **24-25. 3. 2025** në dy shkollat e mesme të larta është mbajtur Olimpiada e kimisë në nivel shkolle ku kanë garuar gjithsej 46 nxënës (klasa X, XI dhe XII), prej të cilëve pesë nxënës kanë marrë pikë për pjesëmarrje në Olimpiadën e kimisë në nivel komunal.

Më **27 mars 2025**, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, pesë nxënës të komunës së Shtimes kanë marrë pjesë në Olimpiadën e gjuhës shqipe në nivel shteti/Kosovës:

1. Alketa Isufi, vendi i parë (ShMU "Emin Duraku" – Shtime),
2. Arlind Latifi, vendi i dytë (ShFMU "Abdullah Shabani" – Carralevë),
3. Dorart Ahmeti, vendi i tretë (ShFMU "Hasan Prishtina" – Godanc),
4. Jona Hasani, vendi i tretë (ShFMU "Hasan Prishtina" – Godanc) dhe
5. Elza Shabani, vendi i tretë (ShMU "Emin Duraku" – Shtime).

Më **27. 3. 2025** në objektin e Gjimnazit "Naim Frashëri" në Shtime është mbajtur Olimpiada e kimisë në nivel komunal, ku morën pjesë tre nxënës nga Gjimnazi "Naim Frashëri" dhe dy nxënës nga Institucioni i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional.

Nr.	Emri dhe mbimeri	Klasa	Shkolla	Pikët
1	Rukije Zeqa	XI-7	IAAP	100 pikë
2	Erza Baftiu	XII-3	Gjimnazi "Naim Frashëri"	90 pikë
3	Leuresa Islami	X-7	IAAP	80 pikë
4	Leonit Avdyli	X-2	Gjimnazi "Naim Frashëri"	60 pikë
5	Blend Hysenaj	XI-4	Gjimnazi "Naim Frashëri"	40 pikë

Më **24 prill 2025** në Gjimnazin "Naim Frashëri" nga Organizata "AMJ Kosova" është mbajtur "Gara e parë akademike ndërkomunale në ese", ku morën pjesë gjithsej 21 nxënës prej të cilëve tre nxënës do të shpërblehen: Vendi i Parë me 4 kuponë shpërblyes në vlerë 250 euro, Vendi i Dytë me 3 kuponë shpërblyes në vlerë 150 euro dhe Vendi i Tretë me 2 kuponë shpërblyes në vlerë 100 euro. Gara për shkrimin e eseve është zhvilluar 45 minuta. Eset e shkruara nga nxënësit klsave X, XI dhe XII janë vlerësuar nga juria e jashtme 4-anëtarëshe. Duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Komunës së Shtimes dhe AMJ Kosova më 24. 4. 2025, në Gjimnazin "Naim Frashëri", në Shtime më **5 maj 2025**, nxënësve fitues u janë dhënë shpërblimet për projektin "Gara e parë akademike ndërkomunale në ese", dhe është bërë mbjellja simbolike e fidanëve në Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani", ku kanë marrë pjesë edhe mysafirë dhe përfaqësues nga ShBA.

Më **26 prill 2025** në ShFMU "Tefik Çanga" në Ferizaj është mbajtur Olimpiada Rajonale e Kimisë, 2025 e organizuar nga Shoqata e Kimistëve të Kosovës. Në këtë Olimpiadë kanë marrë pjesë nxënësit e Gjimnazit "Naim Frashëri" dhe IAAP-së: Nga klasa e X-të, Leresa Islami, Leonit Avdyli dhe Blond Rushiti, nga klasa e XI, Rukije Zeqa, Blend Hysenaj dhe Lentë Tërshana, nga klasa e XII-të, Erza Baftiu, Eulona Gashi dhe Bleart Veseli.

Më **3 maj 2025** është mbajtur Olimpiada Nacionale e Kimisë në Prishtinë, ku komuna e Shtimes është përfaqësuar nga nxënësit: Rukije Zeqa, Erza Baftiu dhe Loresa Islami.

Më **5 maj 2025**, në Mitrovicë është mbajtur Kuizi i Diturisë në lëndën e ekonomisë "Mitrovica, 2025", ku morën pjesë tre nxënës të IAAP-së: Leonora Hyseni, Djellza Krasniqi dhe Dafina Boka. Në mesin e 12-të shkollave konkurruese, nxënësit tanë kanë arritur të zënë vendin e katërt.

Më **9 maj 2025** në ambientet e Bibliotekës së Qytetit në Shtime për nder të 9 Majit - Ditës së Evropës është mbajtur Gara Komunale e Robotikës për klasat I - IX, e cila është realizuar me një atmosferë garuese dhe të përkushtuar nga nxënësit tanë të talentuar. Nxënësit fitues të kësaj gare do të përfaqësojnë me krenari Komunën e Shtimes në garën finale "Kosova Makers League", që do të mbahet në fund të muajit qershor në Prishtinë.

Në ambientet e Shkollës së Mesme të Ulët “Emin Duraku” në Shtime, **14 maj 2025** janë zhvilluar Garat Komunale të Diturisë 2025 për nxënësit e klasave të 6-ta, 7-ta, 8-ta dhe 9-ta. Ky aktivitet është organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe OJQ "Pronet Academy" me qëllim të nxitjes së dijes dhe shprehjes së aftësive të nxënësve në lëndët mësimore.

Garat u zhvilluan në nëntë lëndë: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Teknologji informative, Histori dhe Gjeografi. Procesi i testimit është monitoruar nga zyrtarë të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe zyrtarë të tjerë kompetentë, duke garantuar mbarëvajtjen e drejtë dhe transparente të garës. Në këtë garë morën pjesë gjithsej 215 nxënës nga shtatë shkollat e mesme të ulëta të komunës së Shtimes, prej të cilëve 175 nxënës janë fitues të vendeve të para, dyta dhe treta. Shikuar në bazë të gjinisë, prijnë femrat me 103 vende, kurse meshkujt kanë arritur të marrin vetëm 72 vende. Rezultatet preliminare të garës komunale janë publikuar zyrtarisht, më 16 maj 2025.

Tabela e rezultateve përfundimtare e Gares Komunale të Diturisë, 2025

Nr.	Shkolla	Vendi	Vendi (I)	Vendi (II)	Vendi (III)	Gjithsej
1	ShFMU “E. Duraku”	Shtime	14	8	9	31
2	ShFMU “A. Shabani”	Carralevë	6	15	8	29
3	ShFMU “B. Curri”	Petrovë	8	10	9	27
4	ShFMU “I. Ajeti”	Pjetërshticë	3	12	12	27
5	ShFMU “L. Poradeci”	Muzeqinë	12	14	1	27
6	ShFMU “Skënderbeu”	Reçak	9	6	12	27
7	ShFMU “H. Prishtina”	Godanc	1	2	4	7
Gjithsej:						175

Vlerësim i jashtëm i nxënësve

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë, Standarde, Vlerësim dhe Licencim që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me DKA-në bëjnë organizimin e përvitshëm të vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

Organizimi i Testit “PISA 2025”

Testi “PISA 2025” është realizuar nga data **20-23 maj 2025** në Gjimnazin “Naim Frashëri”, ShMU “Emin Duraku”, Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime dhe ShFMU “Idriz Ajeti”, ku kanë qenë të përfshirë 151 nxënës pesëmbëdhjetëvjeçar.

Fokusin kryesor këtë herë testi “PISA” e ka pasur shkencën dhe mjedisin, i cili është realizuar tërësisht në mënyrë digjitale.

PISA apo Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, është program i Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), i cili mbahet çdo 3 vjet.

Qëllimi i PISA-s është t'i vlerësojë një numër nxënësish të moshës 15-vjeçare rreth njohurive dhe shkathtësive të tyre në tri fusha: matematikë, shkencë dhe lexim.

Provimi i Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2024/2025

Duke u bazuar në Vendimin e MASHTI-it, Nr. 01/008, të datës 25. 2. 2025 për organizimin e Provimit të Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2024/2025, Drejtoria Komunale e Arsimit, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për afatin e parë të Testit të Maturës, i cili do të mbahet më **21 qershor 2025**. Ky test do të mbahet në dy qendra mësimore, gjegjësisht në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime. Testin përmes platformës shtetërore “eKosova” e kanë paraqitur gjithsej 248 nxënës maturantë. Rezultatet do të publikohen më 30. 6. 2025. Përveç paraqitjes së këtij provimi në eKosova gjithashtu nxënësit të cilët e kalojnë provimin e Maturës do të mund ta shkarkojnë certifikatën digjitale.

Testi i Arritshmërisë për vitin 2025

Më **27. 6. 2025** do të organizohet Testi i Arritshmërisë për vitin 2025, në tri qendra mësimore: Në ShMU “Emin Duraku”, në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime. Testit të Arritshmërisë do t'i nënshtrohen gjithsej 368 nxënës të klasave të nënta (IX) të shtatë shkollave të mesme të ulëta të komunës sonë.

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në arsimin fillor (Klasa e Parë) për vitin shkollor 2025/2026

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) nr. 09/2023 për Regjistrimin e Fëmijëve në Klasën e Parë (I), në vitin shkollor 2025/2026, DKA sipas planit dinamik të punës, përmes institucioneve arsimore ka filluar nga data 15 maj deri më 16 qershor 2025 regjistrimin e nxënësve në klasën e parë, të cilët kanë mbushur moshën minimale 6-vjeçare. Gjithashtu në të njëjtën periudhë është realizuar edhe regjistrimi i fëmijëve në klasën përgatitore.

1. Numri i paraleleve të planifikuar për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2025/2026 është 22 paralele;
2. Numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2025/2026 është 330 nxënës.

Planifikimi për regjistrimin e fëmijëve në IP “Albiona Asllani” për vitin shkollor 2025/2026

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, më 6. 4. 2025 është shpallur konkursi publik për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime (Objekti II). Me këtë rast nga institucioni në fjalë, rezultatet janë shpallur më 8. 5. 2025:

Grup-mosha	Nr. i fëmijëve të planifikuar për regjistrim	Nr. i fëmijëve të regjistruar	Nr. i fëmijëve të paregjistruar
09 – 2 vjeç	6	6	3
2 – 3 vjeç	8	8	3
3 – 4 vjeç	11	6	1
4 – 5 vjeç	12	7	1
Gjithsej:	37	27	8

Për Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime (Objekti I), konkursi publik për regjistrimin e fëmijëve në vitin shkollor 2025/2026 është shpallur më 22. 5. 2025, kurse rezultatet janë publikuar më 17 qershor 2025:

Grup-mosha	Nr. i fëmijëve të planifikuar për regjistrim	Nr. i fëmijëve të regjistruar	Nr. i fëmijëve të paregjistruar
09 – 2 vjeç	10	10	3
2 – 3 vjeç	16	14	0
3 – 4 vjeç	8	8	0
4 – 5 vjeç	6	3	0
5 – 6 vjeç	24	24	4
Gjithsej:	64	59	7

Sqarim: Nga viti shkollor 2024/2025 do të vazhdojnë qëndrimin në çerdhe edhe 127 fëmijë të tjerë, të cilët janë të grup-moshave të ndryshme.

Ndërsa për Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Muzeqinë konkursi publik për regjistrimin e fëmijëve për vitin shkollor 2025/2026 është shpallur më 17. 6. 2025

Nr. i klasave	Grup-mosha	Nr. i fëmijëve të planifikuar për regjistrim
1 klasë (dhomë)	09 – 2 vjeç	4
1 klasë (dhomë)	2 – 3 vjeç	2
Gjithsej:		6

Sqarim: Nga viti shkollor 2024/2025 do të vazhdojnë qëndrimin në çerdhe edhe 27 fëmijë të tjerë, të cilët janë të grup-moshave të ndryshme.

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2025/2026

Me kërkesë të MASHTI-it, Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë planifikimin e nevojshëm për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2025/2026. Për vitin shkollor 2025/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime, ka planifikuar regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X):

Shkolla	Drejtimi	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim
Gjimnazi “Naim Frashëri” Shtime	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	4	100
	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	3	75
Gjithsej:		7	175

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) në Shtime për vitin shkollor 2025/2026

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional-Shtime	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	20
		Automekanik	1	20
		Informatikë	1	20
	Agrokulturë, pylltari, peshatari dhe vetrinari	Agrobiznes	1	20
	Ekonomi, administrim dhe juridik	Banka dhe sigurime	1	20
		Kontabilitet	1	20
	Shëndetësi	Bashkëpunëtorë profesional i infermierisë	1	25
	Gjithsej:		7	145

Bursa për studentë për vitin akademik 2024/2025

Më 8 prill 2025, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur Konkurs për Ndarjen e Bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2024/2025. Afati i aplikimit ka qenë 15 ditë. Në vitin paraprak janë ndarë 100 bursa për studentë, ndërsa sivjet është rritur numri i tyre dhe do të ndahen 120 bursa për studentë. Shtimi i numrit të studentëve që do të marrin bursë, do të jetë një mbështetje e fuqishme dhe motiv shtesë, për studentët e dalluar që ta shtojnë përkushtimin e tyre në drejtimet e studimeve që ndjekin. Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore e tyre është 50 euro për student, gjegjësisht 500 euro për një vit. Deri në mbyllje të konkursit kanë aplikuar gjithsej 190 studentë. Komisioni komunalë prej pesë anëtarëve është duke punuar në përzgjedhjen e studentëve duke u bazuar në kriteret e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentë. Me të përfunduar të punës së komisionit, rezultatet preliminare do të publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

Pajisja e institucioneve arsimore me inventar dhe kabinete shkollore

Më **26. 2. 2025** Caritas-i Zviceran-Zyra në Kosovë, në kuadër të Projektit TAKE, ka pajisur Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” me disa pako didaktike-lodra nga druri, të destinuara për përmirsimin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme.

Më **25 mars 2025** është përruruar në ShFMU “Abdullah Shabani” në Carralevë kabineti për lëndën e Kimisë, Fizikës dhe Biologjisë. Me një kabinet të tillë është furnizuar edhe ShFMU “Bajram Curri” në Petrovë. Vlera e përgjithshme e këtyre dy kabineteve për të dy shkollat e komunës sonë është 82 mijë euro.

Në kuadër të projektit “Promovimi i Vlerave Humane”, të mbështetur nga Kryqi i Kuq i Kosovës më **23 prill 2025** në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime është përruruar Biblioteka e shkollës.

Më **30 prill 2025** është nënshkruar marrëveshje në mes të Komunës së Shtimes dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), për furnizim me pajisje shkollore për kabinetet e lëndëve kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi në SHFMU “Emin Duraku: në Shtime. Vlera e marrëveshjes është 12 mijë euro.

Në këtë vit shkollor, Drejtoria Komunale të Arsimit, ka furnizuar me inventar shkollor institucionet shkollore të komunës sonë, ku vlera e përgjithshme e këtij projekti ishte **29,494.00 euro**.

Shkolla	Inventari shkollor	Sasia
ShFMU “Hasan Prishtina”-Godanc	Tabela shkrimi	10
	Karreige për nxënës	175
	Banka për nxënës	88
	Tavolina për mësimdhënës	4
ShFMU “Emin Duraku”-Davidovc	Karreige për nxënës	70
	Banka për nxënës	35
	Tavolina për mësimdhënës	5
ShFMU “Bajram Curri”-Petrovë dhe Mollopolc	Karreige për nxënës	50
	Banka për nxënës	25
	Tavolina për mësimdhënës	4
ShFMU “Lasgush Poradeci”-Gjurkovc, Vojnovc dhe Muzeqinë	Karreige për nxënës	95
	Banka për nxënës	195
	Tavolina për mësimdhënës	16
ShFMU “Abdullah Shabani”-Zborc	Karreige për nxënës	35
	Banka për nxënës	70
	Tavolina për mësimdhënës	5

Në nëntor 2024, Caritas Kosova ka dhuruar 106 banka dhe 212 karriga të reja për ShFMU “Hasan Prishtina” në Godanc, të cilat do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet e mësimin.

Me kërkesë të DKA-së, MASHTI ka furnizuar me lodra për fëmijë tri institucione parashkollore: Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime, Muzeqinë dhe çerdhën e vjetër në Shtime, e cila është rifuksionalizuar.

Investime në infrastrukturën shkollore

- Më **7 nëntor 2024** është përruruar çerdha e re në fshatin Muzeqinë, e cila është çerdhja e parë që po hapet në këtë zonë për fëmijët e Muzeqinës, Vojnovcit, Gjurovcit, Rashincës dhe Gllavicës. Kostoja e adaptimit të objektit të çerdhes në fjalë shkon në 63,881 euro dhe është investim i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Kjo çerdhe ka hapësirë të brendshme 400 metra katrorë, ku mund të vendosen deri në 40 fëmijë.
- Më **21 janar 2025** është përruruar salla e edukatës fizike e ShFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë. Salla e sportit, me një sipërfaqe prej 700 metrash katrorë dhe një vlerë prej 255,404.19 euro, është financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, më 30 dhjetor 2024 ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, më **6 shkurt 2025** kanë filluar punimet në tri shkolla të komunës sonë. Shkollat që do të përfitojnë nga ky projekt janë:
 - ❖ ShF "Emin Duraku" në Shtime: Investim prej 301,604.83 euro;
 - ❖ ShFMU "Hasan Prishtina" në Godanc: Investim prej 306,515.58 euro;
 - ❖ Institucioni i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Shtime: Investim prej 254,333.33 euro.

Masat e planifikuara për t'u implementuar: Termoizolimi i mureve të jashtme dhe çatisë, ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme, instalimi i ndriçimit LED dhe vendosja e kaldasë me pelet dhe renovimi i rrjetit të ngrohjes.

Investimi në eficiencën e energjisë në këto objekte do të na mundësojë jo vetëm kursimin e energjisë dhe reduktimin e kostove operacionale, por edhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit dhe mësimdhënësit tanë.

Projekti do të financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili po implementohet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë përmes skemës kthyesë për financimin e projekteve komunale.

- Në fshatin Godanc, më 20 tetor 2023 është vënë gurthemeli për ndërtimin e çerdhes së re, e cila pritet të përrurohet më 1 shtator 2025. Ndërtimi i çerdhes në fshatin Godanc është investim i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe kap vlerën 414,643.49 mijë euro. Objekti i çerdhes parashihet të ketë sipërfaqe 756 metra katrorë, 5 klasa për fëmijë të grup-moshave 9 muaj deri 5 vjeç dhe të gjitha pjesët përcjellëse të nevojshme.
- Më **21 janar 2025** është vënë gurthemeli për çerdhën e re të Petrovës, me vlerë prej 1,157,656 euro. Ky objekt modern me një sipërfaqe prej 873 metra katrorë është i destinuar për 40 fëmijë. Projekti në fjalë, do të përmirësojë infrastrukturën arsimore dhe krijimin e një mjedisi të sigurt e të përshtatshëm për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve nga mosha hershme.
- Përveç çerdhes, më 21 janar 2025 në Petrovë u vendos edhe gurthemeli për renovimin dhe zgjerimin e shkollës fillore "Bajram Curri," një projekt tjetër madhor me vlerë 1.444.827.85 euro dhe sipërfaqe prej 920 metra katrorë. Po ashtu në objektin e edukatës fizike të kësaj shkolle kanë përfunduar punimet dhe së shpejti fillojnë punimet edhe për renovimin e objektit të vjetër shkollor.
- Më **2 qershor 2025** është rifunksionalizuar çerdhja e vjetër në Bashkësinë e Pestë të Shtimes. Çerdhja "Albiona Asllani" (Objekti II) do të ofrojë kujdes dhe edukim për 40 fëmijë, ndërkohë që stafi është tashmë i punësuar dhe trajnuar për të ofruar shërbime të standardeve të larta në arsim të hershëm.

Renovimi i kësaj çerdheje moderne prej 340 metrash katrorë, është financuar nga MASHTI me vlerë 129.845.14 euro.

- Ka përfunduar rregullimi i rrethojës së shkollës në fshatin Davidovc. Aktualisht është duke vazhduar rregullimi i rrethojës së shkollës në Gjurovc dhe Carralevë. Vlera e përgjithshme e këtij projekti dyvjeçar është 41,853.97 euro.

Sfidat në arsimin parauniversitar

- Problem në vete kemi Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.4.2017 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22. 1. 2021, sipas të cilave parashihen disa përfitime financiare për punonjësit e arsimit, përfshirë pagesën për shujtat ushqimore, shpenzimet e udhëtimit, tri pagat shtesë pas pensionimit, pagat në emër të shpërblimit jubilar, pastaj mjetet financiare për ndryshimet për ngritje profesionale, pagesën e shkallës së inflacionit për çdo vit, pagesën për licencim, pagesën për orët mbi normë për mësimdhënësit klasorë. Duke pasur parasysh implikimet buxhetore të kësaj kontrate, të gjitha komunat e Kosovës kanë probleme financiare në realizimin e investimeve kapitale në shumë projekte komunale meqë detyrohen për t'i shlyer obligimet ndaj mësimdhënësve.
- Sfidë tjetër është rënia e numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar që vit pas viti po ndodhë, për shkak të rënies së natalitetit, migrimit fshat-qytet dhe emigrimit jashtë vendit, ku kjo dukuri është më shumë e shfaqur në shkollat e viseve rurale në komuna të ndryshme të vendit tonë.
- Kemi mungesë të kuadrit profesional në lëndën e matematikës, fizikës, TIK-ut dhe gjuhës gjermane. Kjo dukuri nuk është e shfaqur vetëm në komunën tonë por edhe në komunat tjera.
- Po ashtu kemi kërkesa për rritjen e numrit të asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore por aktualisht kemi numrin e kufizuar për rritjen e stafit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecuresisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Ky raport përmbledh aktivitetet dhe punën e realizuar nga Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Shtimës, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025. Raporti mbulon tre sektorët që ajo menaxhon:

- Sektori i Kujdesit Primar Shëndetësor – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami”
- Qendra për Punë Sociale
- Shërbimet Rezidenciale – Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar Mendore

I. DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Aktivitetet dhe shërbimet e realizuara

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, Drejtoria ka përpunuar dhe trajtuar gjithsej 262 kërkesa të ndryshme nga qytetarët dhe institucionet, nga të cilat:

- 119 kërkesa për përkrahje financiare për nënat lehona me fëmijë të lindur në vitet 2024-2025, në vlerë prej 18,700 €.
- 143 kërkesa për mbështetje shëndetësore, strehim dhe ndihma sociale, prej të cilave 44 janë subvencionuar me 16,256 €, dhe 3 kërkesa për familje strehuese subvencionuar me 5,400 €, në total 21,656 €.
- 13 kërkesa për vërtetime të ndryshme dhe përgjigje administrative, si dhe 81 kërkesa në pritje për shqyrtim nga komisioni.

Në kuadër të mbështetjes së familjeve të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës, është realizuar aktiviteti rehabilitues në vlerë prej 8,500 €.

Gjithashtu, është hapur thirrja publike për aplikimet e Organizatave Joqeveritare për subvencione dhe transfere, të cilat janë duke u shqyrtuar nga Komisioni përkatës.

Projekt i ri – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Shtime

Më 16 Qershor 2025 u bë gurthemeli i objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, me investim rreth 2.4 milion euro, për një sipërfaqe prej afërsisht 3,000 m², që do të sigurojë kushte të standardeve të larta për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në komunë.

II. SEKTORI I SHËNDETËSISË SË KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Vezir Bajrami” dhe njësitë në Muzeqin, Petrovë, Pjetërshticë dhe Godanc

Në periudhën Janar – Maj 2025, janë realizuar:

- 64,281 vizita mjekësore.
- 195,434 shërbime të ndryshme shëndetësore.

Shërbimi i vaksinimit ka përfshirë 1,781 persona, duke përfshirë vaksinimin rutinë dhe atë në shkolla.

Kujdesi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç është kryer nëpërmjet 405 vizitave, prej të cilave 349 kanë qenë vizita shtëpiake për fëmijë dhe 56 për gra shtatzëna.

Programi për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2025, janë organizuar 8 ligjërata të akredituara nga Oda e Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve Shëndetësor (OIK), duke mbështetur avancimin profesional të stafit shëndetësor.

Aktivitetet e tjera shëndetësore

Gjatë periudhës janë realizuar 53 aktivitete të ndryshme, përfshirë:

- Trajnime profesionale dhe fushata vetëdijësuese.
- Vizita edukative në institucione parashkollore dhe në Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore për Ditën Botërore të Shëndetit Oral.
- Kontrollime sistematike për fëmijët parashkollore dhe nxënësit e klasave të para.

III. SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE – QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Raporti i veprimtarive dhe ndihmave

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2025, në kuadër të ndihmave sociale janë shpërndarë gjithsej 772 pako ushqimore nga donatorë të ndryshëm nëpër lokacione të përcaktuara nga komunë.

Gjithashtu, janë lëshuar 251 vërtetime të ndryshme administrative, me një pjesë të tyre me pagesë dhe disa pa pagesë.

Punët dhe aktivitetet kryesore të sektorit

Në këtë periudhë janë trajtuar raste të ndryshme sociale, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, raste të dhunës në familje, ngacmim seksual, mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara mendore dhe personave të moshuar.

Janë zhvilluar vizita, intervista, sesione këshillimi, ndërmjetësime dhe bashkëpunime të vazhdueshme me institucione relevante si policia, gjykatat dhe shkollat.

IV. SHËRBIMET REZIDENCIALE – SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE

Përmbledhje e shërbimeve dhe stafit

Në Shtëpinë e Komunitetit janë të strehuar 11 klientë dhe operojnë 13 punonjës, përfshirë infermierë, ndihmës mjekësorë dhe personel teknik e pastrues, të cilët ofrojnë shërbim 24-orësh me orar fleksibël.

Kujdesi ndaj klientëve

Ofrohen shërbime ushqimore, higjienike dhe shëndetësore, duke përfshirë vizita mjekësore, analiza laboratorike dhe monitorim të vazhdueshëm të gjendjes shëndetësore. Staf i është i angazhuar në përmirësimin e kushteve higjienike dhe mirëqenien e klientëve.

Investimet dhe aktivitetet

Janë realizuar përmirësime në ambientet e banimit, përfshirë ngjyrosjen e mureve, mobiljet e reja në kuzhinë dhe ndërtimin e një aneksi. Për klientët janë organizuar aktivitete sociale, artistike, rekreative dhe udhëtime jashtë objekti, përfshirë vizita në Prevallë.

Mbështetja dhe donacionet

Janë pranuar veshmbathje dhe ushqime nga donatorë lokalë dhe organizata humanitare, për të përmirësuar cilësinë e jetës së klientëve, sidomos gjatë festave dhe periudhave të veçanta.

Furnizimet me barna dhe materiale higjienike janë të mjaftueshme, ndërsa është evidentuar nevoja për staf infermior të ri dhe organizim trajnimesh profesionale për përforcimin e kapaciteteve.

Përfundim:

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Shtimës ka arritur të përmbushë aktivitetet e planifikuara për periudhën raportuese, duke siguruar shërbime të qëndrueshme dhe të standardeve të larta për qytetarët dhe kategoritë më në nevojë. Projektet dhe investimet e planifikuara synojnë përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve.

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecurisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Sa i përket detyrave dhe përgjegjësi të DSHP-së, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 janë realizuar këto punë si në vijim:

- Aktiviteti i inspektorëve ka qenë i fokusuar në inspektime, kryesisht në fushat: mbrojtje të ambientit, shërbime publike dhe komunikacion.
- Detyra e Drejtorisë është zbatimi i ligjeve dhe i të gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga ministrinë përkatëse dhe rregulloret e ndryshme të nivelit qendror apo lokal.
- Duke i zbatuar në praktikë këto ligje, kemi arritur të parandalojmë shumicën e veprimeve që kanë qenë ilegale dhe në kundërshtim me dispozitat e këtyre ligjeve, në të gjitha fushat: tregti, bujqësi, shëndetësi, komunikacion, shërbime publike, mbrojtje të ambientit, duke aplikuar masa ndëshkimore si: aktvendim-urdhër, gjobë mandatore, fletëparaqitje në gjykatë.
- Krejt këto me qëllim që qytetari të ketë një jetë më të shëndetshme, një ambient më të pastër, një qarkullim më të lirë – apo me një fjalë, një jetë më të mirë.

Raport pune nga Inspektorati për Mjedis dhe Ambient – 2025

Inspektorja për Mjedis dhe Ambient, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi gjatë periudhës Janar–Qershor 2025, ka realizuar këto detyra pune:

- Inspektime të vazhdueshme në terren duke monitoruar ndotësit potencialë mjedisorë, të cilët shkaktojnë ndotje mjedisore. Varësisht nga natyra apo shkalla e ndotjes, janë hartuar procesverbale dhe janë shqiptuar vërejtje verbale.

Të dhënat për periudhën janar–qershor 2025:

- Numri i proceseve të hartuara: **25**
- Numri i kërkesave dhe ankesave të pranuar: **2**
- Numri i gjobave të shqiptuara: **3**
- Shuma e gjobave të shqiptuara: **1,700 €**
- Numri i aktvendimeve: **5**

Angazhime shtesë:

- Kryetare e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
 - Numri i vlerësimeve të realizuara nga Komisioni për FN&FT: **9**
- E autorizuar nga Drejtori për raportimin e mbeturinave në AMMK për vitin 2024
- Anëtare e Komisionit për Zbatimin e Sistemit të Performancës Komunale për vitin 2024 për Mbrojtje të Mjedisit dhe Menaxhim të Mbeturinave.

Raport pune për vitin 2025 – Inspektori i Shërbimeve Publike

- Janë menaxhuar 12 kontrata, të proceduara nga Drejtoria e Prokurimit.
- Janë lëshuar 23 leje për qarkullim brenda zonës urbane për automjete mbi shtatë tonë.
- Janë lëshuar 17 pëlqime për aktivitete të ndryshme.
- Janë lëshuar 26 leje pune për autoteksi.
- Janë lëshuar 6 pëlqime për vendosje të verandave në hapësira publike – procesi është ende në vazhdim.
- Janë trajtuar kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.
- Janë hartuar 5 procesverbale të inspektimit.

Në kuadër të **DSHP-së** funksionon edhe Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim. Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim, bazuar në Ligjin për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësi të Tjera (FN&FT), Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri dhe përgjegjësitë që ka, paraqet punën dhe aktivitetet e ndërmarra si dhe gjendjen momentale në komunën tonë, përfshirë edhe çështjen e sigurisë.

Për ngritjen e gatishmërisë emergjente dhe sigurinë e qytetarëve të komunës së Shtimes, ZMSH-ja ka qenë e gatshme për të dhënë kontributin e saj në rast nevojë, kur paraqiten raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera (FN&FT).

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2025, Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim (ZMSH) është angazhuar në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të cilat janë të përcaktuara për këtë sektor, bazuar në planin e punës.

Për përballimin e situatave emergjente nga fatkeqësitë dhe emergjencat e nivelit të lartë, ZMSH-ja ka qenë e angazhuar dhe e përkushtuar në kryerjen e detyrave të përcaktuara.

Aktivitetet e ZMSH-së

- Dokumenti i vlerësimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Shtimes.
- Anëtar i Këshillit për Siguri në Bashkësi – tri takime pune.
- Bashkëpunim me Stacionin Policor të Shtimes për temat që kanë të bëjnë me zonat që paraqesin rrezik për banorët e Komunës së Shtimes.
- Vizita sistematike në institucionet shkollore për vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë.
- Trajnim me Departamentin për Demokratizim / Sektorin për Media dhe Departamentin për Rend dhe Siguri Publike – Njësia e Veçantë për Këshillim.
- Më 15–16 maj 2025: “Ngritja e kapaciteteve të menaxhimit të mediave sociale nga zyrtarët komunalë të komunikimit të Agjencisë për Menaxhim të Emergjencave”
- Bashkëpunimi me Forcën e Sigurisë së Kosovës.
- Rekomandime për rastet emergjente me rrezik të lartë, si dhe gjendja momentale e objekteve që paraqesin rrezik për banorët e Komunës së Shtimes.
- Takime me Qendrën 112 – Situata e sigurisë në Komunën e Shtimes.

Janë mbajtur tri mbledhje të Këshillit për Siguri në Bashkësi, me temën: **“Gjendja e sigurisë në Komunën e Shtimes”**.

Kërkesat që i janë adresuar ZMSH-së kanë qenë: vlerësim i dëmeve në bujqësi dhe ekonomi familjare. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 kemi pasur dëme të nivelit të mesëm dhe, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rënie prej 40%.

Po ashtu, edhe sa i përket rasteve me zjarr dhe sipas të dhënave nga tabela e intervenimeve të Brigadës së Zjarrfikësve, gjashtëmujori i dytë ka treguar përmirësim të situatës, pra kemi një rënie prej rreth 40%, për shkak të vetëdijesimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me qytetarët.

1. Arritjet kryesore

- Zvogëlimi i kohës mesatare të reagimit në incidente nga 14 min në 11.5 min.
- Rritja e pjesëmarrjes në trajnime dhe ushtrime emergjente me 40% krahasuar me vitin e kaluar.
- Rritje e numrit të raporteve të incidentit të dërguara përmes aplikacionit mobil me 75%.
- Krijimi i bazës së të dhënave për furnizimet emergjente në nivel lokal.

2. Sfidat dhe vështirësitë

- Infrastruktura jo e njëtrajtshme nëpër komuna për menaxhimin e të dhënave.
- Mungesa e stafit të trajnuar në disa njësi të largëta.
- Nevoja për procedura standarde më të konsoliduara në rast të ndërhyrjes së shumë njësive në një ngjarje.

4. Përfundim

- Gjashtëmujori i parë i vitit 2025 dëshmoi për përparim të vazhdueshëm në ndërtimin e një administrate më efikase dhe reaguese.
- Me gjithë sfidat, arritjet tregojnë një orientim të qartë drejt forcimit të mekanizmave për menaxhimin e emergjencave në nivel lokal.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecures së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Gjatë periudhës Janar–Qershor në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë zhvilluar shumë aktivitete, të cilat janë të elaboruara në vijim.

15 JANARI 2025 – “DITËT PËRKUJTIMORE TË MASAKRËS SË REÇAKUT”

Në këtë vit, për nder të 15 janarit, janë organizuar “Ditët Përkujtimore të Masakrës së Reçakut”. Aktivitetet janë mbajtur nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në përkujtim dhe nderim të kësaj dite, duke filluar nga data 5 janar.

• **5 janar 2025** – Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 26-vjetorit të Masakrës së Reçakut, të rinjtë e fshatit Reçak kanë organizuar Turnirin Memorial “Ditët e Reçakut”.

- **12 janar 2025** – Me rastin e 26-vjetorit të Masakrës së Reçakut, ShBA “Guri i Shtrenjtë” dhe ShBA “Vjosa” organizuan ecjen tradicionale përkujtimore në shtegun Shtime – Belinc – Rancë – Reçak.
- **14 janar 2024**- Është organizuar ora e parë mësimore, kushtuar 15 janarit, Masakrës së Reçakut në të gjitha shkollat e Komunës së Shtimes dhe të gjithë Kosovës.
- **15 janar 2025**- Në përkujtim të 26-vjetorit të Masakrës së Reçakut, për të nderuar viktimat e kësaj ngjarjeje tragjike, e cila tronditi botën dhe mobilizoi ndërkombëtarët për ndërhyrje, krerët shtetërorë, përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë nga e gjithë Kosova bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule në Kompleksin Memorial në Reçak.
- **15 janar 2025**- Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, u mbajt Akademia Përkujtimore ku u nderuan dhe u përkujtuan 45 civilëve të pafajshëm të masakruar nga forcat serbe. Në këtë ceremoni, krerët më të lartë të shtetit, qytetarët dhe personalitete ndërkombëtare u mbledhën për të rikujtuar këtë akt mizor dhe për të kërkuar drejtësi për viktimat. I pranishëm në Akademi ishte edhe ambasadori William Walker, dëshmitari kryesor i masakrës, i cili e quajti Reçakun si simbol të tragjedisë dhe rezistencës njerëzore.
- **15 janar 2025**- Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u mbajt edicioni i parë i ekspozitës “Çmimi William Walker”.

Në këtë ekspozitë morën pjesë artistë nga rajoni dhe më gjerë, duke paraqitur punime që reflektojnë dhe dokumentojnë dhimbjen, vuajtjet dhe qëndresën e popullit shqiptar gjatë periudhës së luftës. Çmimi kryesor, “William Walker”, iu dha artistit Zenun Sherifi nga Maqedonia e Veriut, për veprën e tij mbresëlënëse që mishëron tragjedinë dhe guximin njerëzor.

- **16 janar 2025**- Në Palestrën e Sporteve në Shtime u zhvillua Turniri Memorial “Ditët e Reçakut”, organizuar me përkushtim nga të rinjtë e fshatit Reçak. Turniri në futboll bashkoi dhjetëra ekipe, duke krijuar një garë të fortë dhe emocionuese. Në finalen e madhe, FC “Vjosa” triumfoi kundër FC “Infra ING”, duke fituar trofeun e turneut përmes një loje të shkëlqyer dhe angazhimi të jashtëzakonshëm.
- **19 janar 2025**- Në përvjetorin e rënies heroike të Komandantit Ahmet Kaçiku, familjarët e dëshmorëve, përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të institucioneve komunale dhe qytetarë, kanë bërë homazhe dhe buqeta lulesh u vendosën pranë varrit të Komandantit të Brigadës 161 në Zonën Operative të Nerodimës.

17 SHKURTI 2025 – 17 VJETORI I PAVARËSISË SË KOSOVËS

Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës është shënuar me aktivitete të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me shkollat, OJQ lokale, AKV “Ilirida” dhe klubet sportive.

- **14 shkurt 2025-** Në Shkollën Profesionale në Shtime është mbajtur një ligjëratë nga përfaqësues të MK-së të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Nerodimës. Kjo ngjarje u organizua me qëllim të kujtimit të sakrificës për lirinë e vendit dhe edukimit patriotik të të rinjve. Ligjërata kryesore u mbajt nga Përparim Luzha, i cili ndau me të pranishmit kujtime dhe mësim nga lufta.
- **14 shkurt 2025-** Në ambientet e Bibliotekës së Qytetit, me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, u organizua gara e pikturimit dhe shkrimit, ku morën pjesë nxënës të shkollave fillore.
- **16 shkurt 2025-** Në një atmosferë festive, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u shënuar Dita e Flamurit të komunitetit Ashkali. Ky aktivitet i rëndësishëm u organizua me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së kulturës, traditave dhe vlerave të këtij komuniteti.
Përmes këtij eventit u përcoll një mesazh i rëndësishëm për ruajtjen e traditave dhe për fuqizimin e bashkëpunimit mes komuniteteve në Kosovë.
- **16 shkurt 2025-** Në vazhden e aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Shoqata Bjeshkatarë Alpiniste (SHBA) “Vjosa” nga Shtimja ka organizuar “Marshin e Pavarësisë”, një ngjarje simbolike që synoi të promovojë bjeshkatarinë dhe vlerat natyrore të vendit tonë.
Marshi i ecjes nisi nga “Sheshi i Flamurit” në fshatin Mollopolc, ku dhjetëra bjeshkatarë dhe dashamirës të natyrës u mbledhën dhe vazhduan rrugëtimin e tyre drejt ujëvarave të Mollopolcit.
Në përfundim të marshit, organizatorët ndanë mirënjohje për bjeshkatarët dhe kontribuuesit që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e SHBA “Vjosa” dhe në promovimin e bjeshkatarisë në Kosovë.
- **16 shkurt 2025-** Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u dha shfaqja teatrale “Lenorë” nën regjinë e Bashkim Ramadani, dramë kjo e cila u mirëprit ngrohtësisht nga publiku i pranishëm.
Shfaqja ishte pjesë e aktiviteteve kulturore me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- **17 shkurt 2025-** Është mbajtur seanca solemne në Kuvendin e Komunës së Shtimes..
Përfaqësues të institucioneve, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, veteranë të UÇK-së dhe familjarë të dëshmorëve si dhe me bashkëqytetarë të shumtë kanë bërë homazhe pranë shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, për të vazhduar më pas në varrezat e dëshmorëve në Shtime. Carralevë, Rancë, Reçak dhe Mollopolc me vendosjen e kurorave me lule.
- Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e kësaj dite historike, Klubi i Motocross-it “Vjosa” nga Shtimja, ka organizuar një parakalim simbolik me motorë nga varrezat e dëshmorëve në Shtime, duke dhënë një mesazh respekti dhe krenarie për të kaluarën heroike të vendit tonë.
- **17 shkurt 2025-** Në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes është mbajtur ceremonia e zgjedhjes së laureatëve të sportit për vitin 2024. Ky aktivitet ishte pjesë e festimeve për 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë së Kosovës, duke vënë në pah sukseset dhe angazhimin e sportistëve dhe klubeve sportive të qytetit.

Viti 2024 ishte një vit i pasur me suksese për sportin në Shtime, ku klubet dhe individët e komunitetit sportiv dëshmuar se puna dhe përkushtimi sjellin rezultate të shkëlqyera.

Në këtë ceremoni, një vëmendje e veçantë iu kushtua veteranëve të sportit, të cilët kanë kontribuar ndër vite në zhvillimin e sportit në Shtime. Me mirënjohje u nderuan:

- Ylber Imeri – ish-futbollist,
- Bajrush Baftiu – ish-hendbollist,
- Adrian Arifi – ish-futbollist dhe
- Emrush Xhema – ish-karateist.

Gjithashtu, u nderuan me mirënjohje *post-mortum* personalitetet e shquara të sportit, të cilët lanë gjurmë të pashlyera në komunitetin sportiv: Taib Zeqa dhe Nebahate Brahaj Gashi, mirënjohjet për të cilët u pranuan nga familjarët e tyre.

Në këtë ceremoni u vlerësuan sportistët më të dalluar të vitit në kategori të ndryshme:

- **Kategoria e Kadetëve**

- Anesa Nuha – volejbolliste (KVF “Vjosa”) – vendi i tretë,
- Anesa Ramadani – volejbolliste (KVF “Vjosa”) – vendi i tretë,
- Anesa Abazi – hendbolliste (KHF “Vjosa”) – vendi i dytë,
- Erion Syla – futbollist (KF “Vjosa”) – vendi i parë.

- **Kategoria e Juniorëve**

- Eliza Miftari – volejbolliste (KVF “Vjosa”) – vendi i tretë
- Anesa Shabani – hendbolliste (KHF “Vjosa”) – vendi i dytë,
- Anesa Ismajli – tenisere – vendi i parë
- Trajnerët dhe Punëtorët më të Dalluar të Sportit:
- Alban Iballi – trajneri më i suksesshëm i senioreve për vitin 2024,
- Avdullah Beqiri – trajneri më i suksesshëm për të rinjtë në vitin 2024,
- Urim Krasniqi – punëtori më i dalluar sportiv për vitin 2024

- **Klubet dhe Skuadrat më të Suksesshme:**

- Klubi më i suksesshëm në sportet ekipore (femrat) – KHF “Vjosa”,
- Skuadra më e suksesshme në kategorinë e pioniereve – KHF “Vjosa”,
- Futbollistja më e suksesshme që ka luajtur në një skuadër tjetër – Fatime Beha.

- **Kategoria e Senioreve – Femrat:**

- Sara Ramadani – volejbolliste (KVF “Vjosa”) – vendi i tretë,
- Elsa Muharremi – volejbolliste (KVF “Vjosa”) – vendi i dytë,
- Vjosa Imeri – hendbolliste (KHF “Vjosa”) – vendi i parë

- **Kategoria e Seniorëve – Meshkujt:**

- Ideal Ademaj – futbollist (KF “Vjosa”), vendi i tretë,
- Albin Syla – futbollist (KF “Shtimja 26” – futsal), vendi i dytë,
- Anton Daka, futbollist (KF “Vjosa”-futsal), vendi i parë.

- **Sportisti më i Suksesshëm në Nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar:**

- Për arritjet e tij të jashtëzakonshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me suksese kulminante në peshkim, Astrit Dauti u shpall Sportisti më i Suksesshëm i Vitit 2024.

Procesi i përzgjedhjes së sportistëve më të suksesshëm u bazua në aplikimet e bëra nga klubet dhe individët, sipas konkursit të hapur nga data 26 dhjetor 2024 deri më 18 janar 2025. Në total, aplikuan 7 klube dhe një individ, duke prezantuar kandidaturat e tyre për çmime në kategori të ndryshme.

- **17 shkurt 2025-** Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime është mbajtur ekspozita me titull “**17 Vepra për 17 Vjetorin e Pavarësisë së Kosovës**”, që solli në pah talentin dhe kreativitetin e nxënësve të Gjimnazit “Naim Frashëri” të Shtimes. Kjo ekspozitë jo vetëm që tregoi pasionin dhe përkushtimin e nxënësve ndaj vendit të tyre, por gjithashtu shërbeu si një mesazh frymëzues për brezat e rinj që të vazhdojnë të kultivojnë artin dhe kulturën kombëtare.
- **17 shkurt 2025-** në datën 17 shkurt, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u mbajt koncerti festiv nga ansambli i këngëve dhe valleve “Ilirida”. Ky koncert solli një program artistik të pasur, duke përcjellë emocion dhe krenari tek të pranishmit. Salla ishte e mbushur me qytetarë që festuan këtë moment historik për Kosovën përmes muzikës dhe valleve tradicionale. Ky aktivitet përmbylli serinë e aktiviteteve të organizuara për këtë përvjetor, duke theksuar rëndësinë e kulturës dhe traditës në ruajtjen e identitetit kombëtar. Aktivitetet u organizuan nën patronatin e Kryetarit të Komunës, Dr. Qemajl Aliu.
- **26 shkurt 2025-** Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u dha shfaqja për fëmijë “Libri Magjik” nga Dashuri Rexhepi, e organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Fëmijët parashkollorë të komunës patën mundësinë të përjetojnë një aventurë të mrekullueshme përmes magjisë së teatrit.

ËSHTË SHËNUAR PËRVJETORI I EPOPESË SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

- **5 mars 2025-** Në të gjitha shkollat e komunës u mbajt ora e parë mësimore kushtuar Epopesë së UÇK-së.
- **5 mars 2025** Kryetari i komunës, bashkë me bashkëpunëtorë, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, veteranë të UÇK-së, familjarë të dëshmorëve, nxënës dhe qytetarë, bënë homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe në varrezat e dëshmorëve në Shtime, Mollopole dhe Reçak.
- **6 mars 2025** - Në shenjë nderimi për luftën dhe sacrificën për liri, delegacioni nga Komuna bëri homazhe edhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- **24 mars 2025** – Është licencuar Kori i Qytetit të cilin e themeluan profesor Besnik Brahimi, Erblina Rexhaj dhe Altin Gashi.

8 PRILL 2025

- Është shënuar dita e komunitetit Rom, aktivitete të ndryshme kulturore janë përkrahur nga DKRS për nder të kësaj dite.
- **17 prill 2025-** Në sallën e Kuvendit të Komunës në Shtime është mbajtur seminari në kuadër të projektit “Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor” (CC4WBs), i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky seminar u organizua nga Fondi i Ballkanit Perëndimor në bashkëpunim me Zyrën e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) në Tiranë. Seminari kishte për qëllim të rrisë kapacitetet e sektorëve kulturor dhe kreativ në rajon, me fokus të veçantë në përmirësimin e qasjes në financa për këto industri.

9 maj 2025- Në ambientet e Bibliotekës së Qytetit u mbajt me sukses Gara Komunale e Robotikës për klasat I–IX, organizuar nga Komuna në bashkëpunim me Qendrën “Alfa Omega”.
Fituesit e Garës Komunale të Robotikës 2025 në Shtime:

Cikli i Ulët (klasat I-V):

- Vendi i parë: Young Innovators – Mentor: Andy Moxon
- Vendi i dytë: Sh.F. “Emin Duraku”, Shtime – Mentore: Florinda Hoxha

Cikli i Lartë (klasat VI-IX):

- Vendi i parë: Biblioteka e Qytetit, Shtime – Mentore: Helena Moxon
- Vendi i dytë: ShFMU “Lasgush Poradeci”, Rashincë – Mentor: Adil Qorrolli
- Vendi i tretë: ShFMU “Emin Duraku”, Shtime – Mentor: Hetem Neziraj

Fituesit e këtyre garave do të përfaqësojnë Komunën e Shtimes në garën finale të Kosova Makers League, e cila do të mbahet në fund të qershorit në Prishtinë.

1 Qershor 2025- Dita ndërkombëtare e Fëmijëve

Aktivitete për fëmijë, ngjyrosje dhe muzikë të cilat u organizuan nga OJQ- Bashkimi Rinor në bashkëpunim me DKRS- në të cilat u mbajt në Sheshin “Ahmet Shtimja”.

2 Qershor 2025

Shfaqje teatrale për fëmijë “ Libri Magjik” me regji të Gëzim Hasani dhe aktorë luajtën Olisa Basha, Etnike Bogaj, Brahim Basha dhe Butrint Lumi e cila shfaqje u mbajt në Shtëpinë e Kulturës.

5 Qershor 2025- në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u Promovua Libri

“Dritë Diturie Nëpër Tetë Dekada” me autor prof. Shaban Halimi.

Për nder të 26 vjetorit të Ditës së Çlirimit, DKRS ka zhvilluar disa aktivitete kulturore, rinore dhe sportive:

11 qershor 2025

- Lojë miqësore në Hendboll nga Klubet e Hendbollit të vajzave KHF “Vjosa” dhe KHF “Ulpiana”
- Koncert festiv nga Ansambli i këngëve dhe valleve “ ILIRIDA”

12 qershor 2025

- Mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës
- Homazhe dhe vendosja e kurorave dhe buqetave me lule te Shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, duke vazhduar te varrezat e deshmorëve të UÇK-së në Shtime, Mollopolc, Recak, Rancë dhe Carralevë.
- Ecja tradicionale e bjeshkatarëve të SHBA “ Vjosa”
- Ekspozita “Gratë në Rugën e Lirisë” e realizuar nga Demrije Salihaj dhe përkraur nga Komuna e Shtimes
- Vizitë në Muzeun e Qytetit nga veteranet e luftës së UÇK-së
- Koncert festiv me këngëtarin e estradës kosovare Korab Shaqiri.

SPORT

Të gjitha klubet sportive kan përfunduar garat e sezonit pranveror dhe kan arritur rezultate të kënaqshme:

- **Klubi i Futbollit “Vjosa”** garon në Ligë e Parë “B” të Futbollit në Republikën e Kosovës dhe janë në vendin e tetë në tabelë, ky klub ka edhe shkollën e futbollit me të gjitha grupmoshat të cilët garojnë regjionit të Ferizajit.
- **Klubi i Futsallit “Vjosa”** garon në Superligën e Kosovës në Futsall, janë duke i zhvilluar garat e sezonit pranveror tani në playoff, gjithashtu kanë qenë finalist të Kupës së Kosovës në Futsall, dhe aktualisht janë në vendin e tretë në tabelë.
- **Klubi i Hendbollit “Vjosa” femrat** – kanë përfunduar garat në sezonin pranveror dhe radhiten në vendin e tretë në ligën e parë të hendbollit të Kosovës, ndërsa vazhdojnë garat me grupmoshat e pioniereve ku kryesojnë tabelen në ligën e pioniereve.
- **Klubi i Futsallit “Shtimja 26”** – ky klub është themeluar në vitin e kaluar, por falë organizimit të mirë kan filluar garat në Ligën e Parë të Futsallit në sezonin vjeshtor të vitit 2024, dhe tani i kan përfunduar garat në sezonin pranveror dhe kan arritur rezultate shumë të mira, gjithashtu kan qenë edhe gjysëm finalist të Kupës së Kosovës në Futsall. Ky klub tani është inkuadruar në Superligën e Kosovës në Futsall.
- **Klubi i Hendbollit “Vjosa” meshkujt** - kanë disa ndeshje por nuk i kan vazhduar garat tutje në Superligën e Kosovës në Hendboll dhe janë suspenduar nga garat.
- **Klubi i Volejbollit “Vjosa” femrat** – i kanë zhvillu garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës, dhe kan arrit rezultate të mira dhe radhiten në vendin e Ky klub me ftesë të qytetarit të nderit të Komunës së Shtimes, Hartmut Ganzke, ka qëndruar për vizitë në Gjermani. Gjatë qëndrimit në Gjermani në Unna, vajzat e Klubit “Vjosa” kan zhvilluar dy ndeshje miqësore me ekipet vendase, EVC Massen dhe GSV Fröndenberg, ku në të dy ndeshjet KV”Vjosa” doli fituese me rezultat 3:0.
- **Klubi i Volejbollit “Vjosa” meshkujt** – nuk kanë zhvilluar garat në sezonin pranveror në ligën e parë të volejbollit të Kosovës, tani kan filluar përgatitjet për sezonin vjeshtor që të zhvillojnë garat.
- **Klubi i Veteranëve të Futbollit “Vjosa”** - janë duke i zhvilluar garat në Ligën e Veteranëve në Futboll.
- **Klubi i Çiklizmit “Vjosa”** – klubi i Çiklizmit „Vjosa” në mungesë të fondeve nuk kan zhvilluar aktivitete dhe garat, por do të marrin pjesë në kampionatin shtetëror nga data 19,21 dhe 22 qershor 2025.
- **Klubi i Motocrossit “Vjosa”** – ka realizuar garën në kuadër të Federatës të Motocrossit në Kosovës, e cila është mbajtur në Shtime. Në këtë garë morën pjesë mbi 50 garues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, duke dëshmuar karakterin ndërkombëtar të aktivitetit dhe nivelin e lartë të organizimit. Halit Rexhaj, Imer Salihaj dhe Alban Ademaj, këta sportistë u dalluan në garën "MX Vjosa Race" duke zënë vendin e parë, të dytë dhe të tretë.
- **Klubi i Kik-Boksit “Skender Salihaj”** – kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Fedeartës së Kik-Boksit të Kosovës, kanë marr pjesë në kupën botërore që është mbajtur në Turqi, ku nga ky klub kan marr pjesë këta kikboksierë , Arbër Salihaj, Erinda Velu dhe Taulant Salihaj si dhe treneri Nesret Salihaj
- **Klubi i Boksit “Skender Salihaj”** - janë zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të kalendarit të Fedeartës së Boksit të Kosovës, kanë marrë pjesë në turne të ndryshëm në Kosovë.
- **Klubi i Karatesë “Vjosa”** - kanë zhvilluar garat në kuadër të Federatës së Karates të Kosovës.
- **SHBA”Guri i Shtrejtntë” dhe SHBA”Vjosa** -kan zhvilluar disa aktivitete të bjeshkatarisë, ecje me rastin e datave me rëndësi në komunën e Shtimes.

SUBVENCIONET

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë kësaj periudhe, ka bërë tri thirrje publike për përkrahje financiare për OJQ-të rinore, kulturore dhe klubet sportive.

Thirrja për sport ka vlerën prej 70,000.00€ dhe ka përfunduar, kanë përfutur 19 klube sportive e shoqata sportive-rekreative dhe 2 individ (të bashkangjitur do të keni edhe vedimin e komisionit të subvencioneve me listen e përfutuesve)

Thirrja për Kulturë dhe për Rini ka vlerën prej 25,000.00€, ka përfunduar por ende nuk janë shqyrtuar nga komisioni.

Thirrja për Mbështetje të Autorit ka vlerën prej 5,000.00€ dhe ka përfunduar aplikimi, por ende nuk janë shqyrtuar nga komisioni për subvencione.

MUZEU I QYTETIT

Gjatë periudhës janar- qershor, Muzeun e Qytetit e kanë vizituar (349) vizitorë ku (170) prej tyre kanë qenë meshkuj dhe (179) prej tyre femra, po ashtu në mënyrë të organizuar kanë vizituar muzeun, gazetarë, studentë të historisë, nxënës të shkollave, të cilët kanë parë për së afërmi reliket dhe eksponatet që janë në muze dhe kanë mësuar për historinë dhe vlerat e muzeut, pastaj ka pasur vizita edhe nga OJQ-ët dhe televizionet e ndryshme. institucionet etj.

Më datë 29.04.2025 Lumturiqe Lubovci nga fshati Godanc I Ulët ka sjell në Muze:

Dy arka për rroba, një fun, një furk, një bosht, dy shtiza, dy pshallaka, një këmish pëlhure edhe një llull të gjitha të vjetra mbi 50 vite nga Nëna e saj Feride Lubovci.

BIBLIOTEKA E QYTETIT

Ky raport përmbledh aktivitetet, statistikën dhe të arriturat e Bibliotekës së Qytetit- Shtime gjatë periudhës janar – qershor 2025. Biblioteka ka qenë aktive në organizimin e aktiviteteve edukative dhe kulturore për fëmijë, të rinj dhe komunitetin e gjerë, duke synuar zhvillimin e shprehisë së leximit dhe edukimit digjital.

1. Statistikat Kryesore

- Anëtarë të rinj: 106
- Lexues të regjistruar: 552
- Lexues aktivë: 425
- Libra të huazuar: 545
- Libra të kthyer: 546
- Tituj të rinj të pranuar: 667 nga këto 167 tituj të rinjë janë donacion me vlerë 540 € nga miqtë e qendres Alfa Omega Shtime, nga Australia.

2. Aktivitetet e Zhvilluara

- 17 Shkurt 2025 – Aktivitet kreativ: Lexim dhe Pikturim, me pjesëmarrje të rreth 115 fëmijëve. Punimet më të mira u shpërblyen me dhurata simbolike.
- 19 Shkurt 2025 – Fillimi i Orës së Leximit për të Vegjlit, tashmë aktivitet i rregullt që mbahet çdo të mërkurë, ora 10:00.
- Çdo të martë – Kursi i robotikës, ku fëmijët përgatiten për garat e Kosova Makers League, aktiv që nga viti 2021.
- Përgjatë muajit mars – janë mbajtur dy punëtori për qytetari digjital, në bashkëpunim me organizatën Bonevet.
- 21 Mars 2025 – Aktivitet për Ditën Botërore të Poezisë, me pjesëmarrje të të rinjë krijues dhe lexim të poezive.

- Prill 2025 – U shënua Dita Ndërkombëtare e Librit, me aktivitete gjithëpërfshirëse: lexim, punëtori, kënde pikturimi dhe dhurim librash.
 - Vizita zyrtare e Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e cila vlerësoi punën dhe angazhimin e bibliotekës në edukimin e gjeneratave të reja.
 - Vizitë e miqve anglez nga Qendra 'Alfa Omega' të cilët dhuruan rreth 400 libra në gjuhën angleze.
3. **Bashkëpunime**
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me shkollat e komunës për vizita dhe aktivitete të përbashkëta.
 - Partneritet me organizatën Bonevet për zhvillimin e kompetencave digjitale.
 - Pjesëmarrje në platformën Kosova Makers League për edukim teknologjik dhe inovativ.

Më 9 Maj 2025 në Bibliotekën është mbajtur gara komunale e robotikës.

Në Bibliotekën e Qytetit çdo të martë dhe të premte mbahet kursi i robotikës dhe çdo të mërkurë mbahet orë leximi për të vegjlit.

SHTËPIA E KULTURËS

Të gjitha aktivitetet që janë mbajtur në Shtëpinë e Kulturës:

- 15 janar 2025 - Akademia përkujtimore e Masakrës së Reçakut
- 15 janar 2025 - Ekspozita William Volker
- 19 janar 2025 - Filmi Premierë “ Ku je nanë ? “
- 23 janar 2025 - Vizita e William Volker në Ekspozitë
- 31 janar - 7 shkurt 2025 - KQZ, Trajnim
- 14 shkurt 2025 - Program Shkollor IAAP - Festa e Pavarësisë
- 14 shkurt 2025 - Video Klipi i këngëtares, Shkurte Fejza
- 16 shkurt 2025 - Festa e Flamurit të Ashkanlinjëve
- 16 shkurt 2025 - Shfaqja Teatrale “ Lenor ” Prishtinë
- 17 shkurt 2025 - Koncerti “ AKV Ilirida “
- 26 shkurt 2025 - Shfaqje për fëmijë “ Libri Magjik “
- 7 mars 2025 - OJQ Linku - Garat e diturisë dhe filmi dokumentar Arsimi në Komunën e Shtimes
- 3 prill 2025 - Trajnimi për bujqit e Komunës së Shtimes
- 10 prill 2025 - Film Dokumentar për Heroin Afrim Selmanaj
- 6 maj 2025 - Festivali i Filmit FERFILM
- 8 maj 2025 - Prova nga Shkolla Filllore për Festën e Abetarës
- 16 maj 2025- Festa e Abetarës nga Shkolla Filllore ‘Emin Duraku’

INVESTIMET KAPITALE

Projektet kapitale që janë të planifikuara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2025 janë:

- Projekti “Ndriçimi në fushat sportive në fshatrat Vojnoc, Davidoc, Carralevë, Pjetërshticë, Shtime, Godanc i Epërm, Gllavicë dhe Zborc”. Ky projekt është dy vjeçar dhe ka vlerën 35,000.00€.
- Projekti “Instalimi, vendosja dhe funksionalizimi i kamerave në objektin kulturor dhe qendrën sportive në Rr. "Skender Salihu" në Shtime” dhe ka vlerën 20,000.00€ dhe është projekt dy vjeçar.
- Projekti “Rregullimi i oborrit të bibliotekës së Qytetit” ka vlerën 30,000.00€ dhe është projekt dy vjeçar.
- Projekti “Konverzimi dhe inventarizimi i ekspozitave në Muzeun e Qytetit”, gjithashtu edhe ky projekt është dy vjeçar dhe ka vlerën 45,000.00€

PROJEKTET PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME, disa janë ende në procedurë të prokurimit dhe disa kanë përfunduar dhe janë lidhur kontratat si:

Furnizimi me buqeta lulesh, e cila ka vlerën prej 1,090.00€

Furnizimi i zyres nga DKRS, kemi vlerën prej 1,211.00€

Furnizimi me material higjienik nga DKRS, kemi vlerën prej 544.95€

Furnizimi me pajisje tjera nga DKRS, vlera është 930.00€

Furnizimi me printer/fotokopjues nga DKRS, kemi vlerën 500.00€

Koktej me rastin e festave nga DKRS, ende është në procedurë të prokurimit dhe nga DKRS kemi të planifikuar vlerën 1,500.00€

Projekti për manifestimin e Festave Shtetërore dhe Komunale, janë të planifikuara 68,000.00€ për dy vite. kontrat kornizë, ka përfunduar procesi i tenderimit dhe tani është në procesin e vlersimit.

PROJEKTET E PËRKRAHURA NGA MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Projekti, Punët ndërtimore për zbatimin e hollësishëm të arkitekturës dhe inxhinierisë për zgjerimin dhe renovimin e Stadiumit të Qytetit, në këtë projekt punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe pritet të përfundojnë sipas planit të menaxhimit..

Projekti, Renovimi i Palestrës së Qytetit, punimet në këtë projekt janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe vlera e këtij projekti është 528,638.50€.

Restaurimi dhe Renovimi i Shtëpisë së Përshpirtshme, punimet në këtë projekt janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe planit të menaxhimit, ky projekt ka vlerën prej 696,575.15€ .

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecures së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është përgjegjëse për ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale të Komunës. Po ashtu, ofron shërbime administrative për qytetarët e Komunës së Shtimes përmes: Qendrës për Shërbim për Qytetarë dhe Gjendjes Civile.

- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme është kujdesur që të gjitha dokumentet e dala nga administrata, e në veçanti sektori i Gjendjes Civile, të jenë lëshuar në pajtim me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi.
- Nga 21 projektet që kemi gjetur në planifikimin e prokurimit për këtë vit, vetëm 6 nuk janë nisur; të gjitha të tjerat janë të përfunduara.
- Është nënshkruar vendimi për përdorimin e automjeteve zyrtare.
- Të gjithë sektorët që janë në kuadër të DAP-it janë obliguar të dërgojnë raporte javore për punën dhe aktivitetet e tyre.
- Plani për Integritet është në përfundim; kanë mbetur vetëm disa hapa formalë për t'u përmbushur, në bazë të rekomandimeve të Agjencisë Kundër Korrupsionit.
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka aplikuar në projektin e GIZ-it për rrjet falas në Sheshin "Ahmet Shtimja".

Sekretaria e Kuvendit Komunal

Në protokollin e Zyrës së Kuvendit, deri më datën 13.06.2025, janë të evidentuara 215 dokumente të ndryshme, të cilat janë të përfunduara. Në mesin e këtyre dokumenteve ka: rregullore, strategji, plane, vendime, rekomandime, konkluzione, ftesa, procesverbale, raporte periodike për MAPL, pyetje-përgjigje, vërtetime, etj. Të gjitha aktet e aprovuara në Kuvend janë dërguar brenda afatit ligjor në MAPL për vlerësimin e ligjshmërisë, si dhe janë dërguar në Zyrën për Informim për publikimin e tyre në ueb-faqen e Komunës. Aktet janë hartuar, harmonizuar me legjislacionin pozitiv të Kosovës, janë nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit, janë vulosur dhe shpërndarë tek të gjitha palët e interesit.

Aktet e miratuara në Kuvend, në periudhën Janar-Qershor 2025, janë si vijon:

- 2 rregullore
- 36 vendime
- 2 plane
- 1

strategji

Në total: 41 akte të miratuara.

Aktet e kthyer nga MAPL-ja për rishqyrtim në Kuvendin e Komunës së Shtimes janë gjithsej 4 raste.

Qendra për Shërbim për Qytetarë, Gjendja Civile dhe Zyra për Arkivë

Gjatë këtij 6-mujori, në Qendrën për Shërbim për Qytetarë janë adresuar 14,129 kërkesa. Këto kërkesa janë të ndara sipas kategorive si më poshtë:

- Kuvendi Komunal – 44 ftesa/kërkesa
- Zyra e Kryetarit (*që përfshin të gjithë sektorët në kuadër të saj*) – 70 kërkesa
- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme (*së bashku me dokumente të Gjendjes Civile*) – 9.928 kërkesa
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik – 7 kërkesa
- Drejtoria për Arsim – 95 kërkesa
- Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Kadastër – 2,904 kërkesa
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – 283 kërkesa
- Drejtoria për Shërbime Publike - 528 kërkesa.
- Drejtoria për Kulture, Rini dhe Sport – 66 kërkesa.
- Drejtoria për Inovacion - 0
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa - 0
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – 204 kërkesa.

Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra për Arkivë

Tek **Zyra e Gjendjes Civile** kemi pasur **11,259 kërkesa**, kryesisht për : certifikata të lindjes, martesës, vdekjes, shtetësisë, vendbanimit, ekstrakte, deklarata të bashkësisë familjare dhe vërtetime nga arkiva. Nga këto, 8,072 kanë qenë për përdorim brenda vendit, ndërsa 3,187 për jashtë vendit. Me pagesë kanë qenë 9,884 kërkesa, ndërsa të liruar nga pagesa – 1,369.

Nga **Zyra për Arkivë**, gjatë këtij 6-mujori janë arkivuar lëndë të ndryshme të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024, si më poshtë:

- Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Kadastër – 18 folderë
- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme – 6 folderë
- Kuvendi Komunal – 7 folderë
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – 10 folderë
- Zyra e Kryetarit – 1 folder
- Drejtoria për Shërbime Publike – 3 folderë

Gjithashtu janë evidentuar:

- Fatura të protokolluara – 791
- Shkresa të pranuar nga posta – 795
- Shkresa të dërguara – 621
- Shkresa të kthyer nga posta – 0
- Lëndë të kërkuara në Arkiv – 1

Zyra e Teknologjisë Informative

Zyrtarët për IT kanë kryer të gjitha shërbimet e Komunës së Shtimes në fushën e teknologjisë informative, duke dhënë përkrahje teknike dhe profesionale për zyrtarët e administratës dhe Kuvendin Komunal, si dhe për sistemin e teknologjisë në përgjithësi. Përveç shërbimeve të përditshme, administrata është furnizuar edhe me **20 kompjuterë të rinj**. Kompjuterët janë shpërndarë te zyrtarët që kanë pasur më së shumti nevojë, ndërsa **2–4 janë lënë në rezervë** për çdo rast.

Po ashtu, është nënshkruar **kontrata për mirëmbajtje të teknologjisë informative**.

Sektori i Shërbimeve Teknike

Sipas raporteve javore, mujore dhe kërkesave të dërguara Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, për faturat e pranuar në depo dhe daljet nga depoja, nga data 01.01.2025 deri më 15.06.2025, nga ana e zyrtarit për depo janë kryer këto punë:

- Fatura të pranuar: 114 fatura
- Dalje nga depoja (mallra dhe shërbime): 51 dalje
- Ngarkime, transfere dhe shkarkime të malirave: 230 dalje
- Fatura të procesuara në FreeBalance: 312 fatura
- Kërkesa për pagesë të faturave: 35 kërkesa

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecurisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Aktivitetet për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në komunën e Shtimes dhe të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022–2026

- Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit, si dhe bashkëpunimi me palët e interesit
- Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve
- Çështje të tjera
- Buxheti
 - Kemi një rast të kthimit të një familjeje nga komuniteti Ashkali në Komunën e Shtimës;
 - Planifikimi i buxhetit për subvencione të ZKKK-së – 10,000 €;
 - Kërkesat individuale për përkrahje në shëndetësi, strehim dhe banim nga buxheti i komunës për ZKKK-në;

Thirrje publike për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ-ve lokale që kanë projekte që kontribuojnë në interesat e përgjithshme të komuniteteve.

- Në fillim të vitit shkollor 2024/2025 kanë qenë të regjistruar 158 nxënës nga komunitetet Ashkali dhe Rom. Në shkollën e mesme kanë vijuar rregullisht mësimin 23 nxënës nga këto komunitete. Në nivelin parafillor janë 7 fëmijë nga komunitetet; gjithashtu, janë të regjistruar 3 studentë – 2 në nivelin Bachelor dhe 1 në Master.
- Për nxënësit e komuniteteve është mbajtur mësimi shtesë në Qendrën për Mësimnxënie, e cila funksionon në SHFMU “Emin Duraku”, në Shtime.
- Nxënësit e komuniteteve Ashkali dhe Rom, që vijojnë shkollën e mesme, kanë përfutur bursa (22 bursa për vitin shkollor 2024/2025, për 10 muaj, nga 40 € në muaj). Pagesa është në procedurë të zbatimit nga Ministria e Arsimit.

Në bashkëpunim me IOM-in janë në pritje 22 aplikime për projekte Start UP LOT 1 (pajisje për ndërtimtari dhe pajisje bujqësore). Dhe një kabinet për Fizikë, Biologji, Matematikë.

Është hartuar lista prioritare për ndërtim dhe riparim të shtëpive, pas vizitave në terren.

Aktivitetet për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, sipas Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Shtimës.

- ZKKK ka bashkëpunuar me drejtoritë e shkollave dhe ka përcjellë vijimësinë e nxënësve të komuniteteve në fillim të vitit shkollor 2024/2025.

Me nxënësit e klasës së 12-të të komunitetit Ashkali dhe Rom kemi mbajtur një takim. Qëllimi i këtij takimi ka qenë që këta nxënës t'i motivojmë që të vazhdojnë fakultetin.

• Shkolla fillore (klasa 1 deri 9):	135	nxënës	që	vijojnë	mësimin
• Shkolla e mesme:	23	nxënës	që	vijojnë	mësimin
• Fakultet:		3			studentë
• Parashkollor:		7			fëmijë
• Qerdhe:		0			fëmijë

• Gjithsej: 158 nxënës

Braktisje nuk ka pasur.

Ka tentim për braktisje (mungesa të shumta të nxënësve).

Për fëmijët e komuniteteve është organizuar mësim shtesë në Qendrën për Mësimnxënie nga OJQ “Balkan Sunflowers Kosova”, e cila funksionon në objekt të Shkollës SHFMU “Emin Duraku” në Shtime. Si zyrë, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me koordinatoren e kësaj qendre dhe kemi përkrahur aktivitetet e saj.

Projektet në teren për komunitetet dhe përfituesit, si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara.

Në bashkëpunim me IOM-in, janë në pritje për realizimin e 22 kërkesave në projekte individuale në biznese në kuadër të projektit Start Up Lot 1.

Jemi në pritje edhe për një kabinet në shkollën ku vijojnë nxënësit e komunitetit.

Faza e parë:

Gjatë fazës së parë të zbatimit të projektit nga IOM-i, një përfitues nga komuniteti, me profesionin agjuntator, ka përfituar mbështetje në kuadër të një projekti individual me vlerë prej 3,000 eurosh, me participim 10% nga përfituesi. Mbështetja është ofruar me qëllim fuqizimin ekonomik dhe nxitjen e vetëpunësimit, përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe sigurimit të mjeteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Aprovimi i kabinetit në shkollën Emin Duraku me vlerë 12,000 euro, me participim nga komuna me vlerë 2,000 euro.

Një përfitues i projektit individual Start Up biznesit me vlerë 3,000 euro.

Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve - Çështje të tjera ose aktivitete:

Si zyrë e ZKKK-së, kemi ofruar ndihmë për plotësimin e formularëve dhe printimin e dokumentacionit për dorëzim në kuadër të skemës së granteve për fuqizim ekonomik, përmes mbështetjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Nxënësve të shkollës së mesme, klasës së 12, ju kemi ndihmuar të aplikojnë për testin e maturës. Si zyrë kemi bërë vizita në disa familje për t'i parë nga afër problemet që ata hasin.

Gjithashtu, tre (3) familje nga komuniteti Ashkali kanë përfutur pako ushqimore në vlerë prej 1,100 eurosh, të ofruara nga GIZ-i gjerman:

- Baki Jakupi – 400 €
- Lebibe Shabani – 400 €
- Shaban Shabani – 300 €
- Gjithsej totali: 1,100 euro

Të punësuar nga radhët e komuniteteve pakicë (Ashkali dhe Rom) në institucionet e Komunës së Shtimës dhe në njësitë e kompanive rajonale, 2025:

I	Administrata Komunale	M	F	Gjithsej
		1	1	2
2	QKMF	///	1	1
3	Shkolla	5	///	5
4	Policia e Kosovës Administrata Komunale	2	///	2
5	Shtëpia e komunitetit	///	///	///
6	KR “ Pastërtia “	4	///	4
	GJITHSEJ	12	2	14

Buxheti:

Nga buxheti për **Zyrën ZKKK – Subvencione**, për këtë vit janë ndarë 10,000 euro për kërkesat individuale dhe publike.

Përfutuesit nga subvencionet e ndara nga ZKKK-ja për gjashtëmujorin e parë:

- **OJQ-ASU** – 3,500 euro është aprovuar
- **Kërkesat individuale** – 2,685 euro në pritje

Punët dhe aktivitetet e ZKKK-së janë realizuar në harmoni me:

- Planin vjetor të punës së ZKKK-së, 2025;
- Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2022-2026;
- Rregulloren (QRK) - Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme;

- Rregulloren 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar;
- Planin Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në komunën e Shtimes;
- Planin Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019–2022;
- Marrëveshjen e bashkëpunimit mes Komunës, Qeverisë dhe IOM-it për realizimin e Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve V (EU CSP V);
- Plan Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Shtimës, 2023–2025;
- Strategjia për Migrim 2021-2025;
- Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecures së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Puna dhe aktiviteti në drejtori është e organizuar në tri sektor:

1. Sektori për Planifikim Urban, Mjedis dhe Ndërtim me 3 zyrtarë,
2. Sektori për Kadastër dhe pronësi me 3 zyrtarë,
3. Sektori për Gjeodezi me 3 zyrtarë.

SEKTORI PËR URBANIZËM DHE NDËRTIM

Gjatë periudhës janar-dhjetor në Sektorin për Urbanizëm dhe Ndërtim janë kryer të gjitha punët të cilat janë paraparë në përshkrimin e detyrave si dhe punët tjera të cilat janë paraqitur gjatë këtyre muajve, këto punë janë të përshkruara në vijim:

Njësia për Urbanizëm:

- Objektivat janë arritur në një nivel të kënaqshëm dhe po ashtu po vazhdohet me realizimin e tyre. Janë përmbushur të gjitha kërkesat për aplikimin e planeve hapësimore të cilat i kemi në fuqi po ashtu janë trajtuar të gjitha kërkesat për kushte dhe leje ndërtimore, janë shqyrtuar të gjitha lëndet për kërkesa të ndryshme si dhe lëshimi i referencave. Po ashtu njësia për urbanizëm ka trajtuar edhe çështjen e legalizimit të objekteve pa leje ndërtimore.
- **Jane trajtuar 17 lëndë, prej tyre 14 janë përfunduar;**
- **Gjatë kësaj periudhe kemi përfunduar edhe hartimin e projekteve ideore dhe kryesore për Komunën e Shtimes.**
- Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe ka filluar edhe Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartes Zonale Komunale, bartëse e këtij projekti është Sektori për Urbanizëm.

Njësia për Ndërtim

- Gjatë kësaj periudhe sektori për ndërtim ka bërë përgatitjen e projekteve të investimeve kapitale si dhe në menaxhimin e tyre gjatë hartimit të projekteve detale.
- Gjatë këtij viti janë menaxhuar disa kontrata të projekteve të vitit të kaluar të cilat janë dyvjeçare dhe shumë kontrata tjera të reja,
- Menaxhimi i hartimit të projekteve detale me kompaninë e përzgjedhur i cili është realizuar për disa projekte dhe është në vazhdimësi .

Njësia për Urbanizëm:

- Zbatimi i Ligjeve dhe Udhëzuesve për Planifikim Urban dhe Ndërtim si dhe Zbatimi i PZHK-s, dhe PRRU-s
 - Lëshimi i Lejeve Ndërtimore (**9 Leje Ndërtimore**)
 - Lëshimi i Kushteve Ndërtimore (**12 Kushte Ndërtimore**)
 - Lëshimi i Lejeve Rrenimi (**1 Leje Rrëni**)
 - Lëshimi i Certifikatave të Përdorimit sipas Ligjit të Ndërtimit nr.04/L-110 (1 Certifikatë të Përdorimit)
 - Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave në Sektorin për Urbanizëm (**51 kërkesa dhe ankesa të ndryshme të cilat janë paraqitur nga qytetarët e ndryshëm**)
- Gjatë këtij viti Sektori për Urbanizëm ka mbledhur 21,460.52€ nga Lejet Ndërtimore, Referencat, Pëlqimet dhe kërkesave të ndryshme të cilat janë parashtruar në këtë sektor.**
- Gjatë këtij viti Sektori për Urbanizëm ka mbledhur 198.24€ nga Lejet Rrëni.**
- Gjatë këtij viti të hyra nga Legalizimi i Ndërtimeve pa Leje janë mbledhur 2076.61€**
- Gjithsej të hyra nga sektori për Urbanizëm janë 23,735.37€.**

Tabela më poshtë paraqet Raportin e zyrtares për fleta poseduese të pronave:

RAPORTI ----- GJASHT MUJORI -2025 –KADRIJE ZEQA						
	MUAJI	FLET.POS.	KOP.PLAN	VËRTET.	KERKESA	TOTALI
1	JANARI	456	409	22		887
2	SHKURTI	328	287	5		620
3	MARSI	594	528	39		722
						2229 EURO
	KERKESA					
1	JANARI	228	204	22		
2	SHKURTI	164	143	5		
3	MARSI	153	122	39		
	TOTALI	545	469	66		GJITHSEJT - 1080 KERKESA PER -3- MUJO
4	PRILLI	394	320	14		728+99=827
5	MAJI	776	412	12		1200+2=1202
6	QERSHORI	340	224	5		569
						2598 EURO
	KERKESA					
1.	PRILLI	197	160	14		
2.	MAJI	388	206	12		
3.	QERSHORI	170	112	5		
		755	478	21	Gjithsejt: 1254kerkesa	
	TOTALI:	1300	1195	87		
	GJITHS>KERKESA- GJASHT MUJOR	2582 KERKESA				Gjithsejt Gjashtmujori- 2025-Totali – 4827 euro

Tabela më poshtë pasqyron Raportin e zyrtares për ndërrime në aparatn kadastral:

NUMRI I LËNDËVE prej 01.01.2025 DERI NË 30.06.2025-											
	JAN.	SHKUR.	MARS	PRILL	MAJ	QER.	KORR.	GUSHT	SHTAT.	TETOR	NËN
BARTJE(SHITB.DHUR.TRASH)	71	69	50	56	74	58					
HIPOTEKA	5	4	7	3	1	4					

AKTGJYKIME CIVILE	0	1	0	2	2						
PËRMIRSIME NË FL.POS.	12	6	11	7	13	13					
MASA TË PËRKOSSHME	1	0	0	1	1						
KËRKESA TË TJERA	8	8	1	2	5	2					
FSHIERJE TË HIPOTEKËS	6	0	4	7	1	1					
BASHKIM NGASTRE	6	4	2	1	1	2					
COPTIM NGASTRE	30	34	20	20	30	12					
REGJISTRIM I NDËRT.	0	3	10	1	1	1					
DHËNJE NË SHFRY. K.K.	0	0	0								
KËMBIM	3	0	0	1	1	1					
FSHIRJE E BARRES TATIM.	0	0	1	1	1						
qirambajtje për 99 vite	2	3	1	2	2						
fshierje e masës së përkoh.	0	0	0								
barrë tatimore	0	0	1	1		1					
ndarje fizike	1	0		2	2	2					
GJITHSEJ:	145	132	108	107	135	97					

Gjatë vitit 2024 në bazë të U.A 03/2016, për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së palujtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve në Sektorin e Kadastrit në Shtime janë regjistruar 72 raste të bashkëpronësisë në bazë të këtij udhëzimi, sipas të cilit të gjitha rastet janë liruar nga taksa komunale, ndërsa prona të regjistruar gjithsejt kan qen 161, ku 68 prona janë regjistruar në emër të grave.

Spektori për Gjeodezi

1. Identifikim ngastre në zyre dhe teren.
2. Identifikimin e rasteve në zyre dhe teren për KEDS.
3. Identifikimin e pronave komunale për dhënie në shfrytëzim.
4. Identifikimi i Pronave Shoqërore dhe Ekonomisë Pyjore.
5. Identifikimi në teren përmes matjeve gjeodezike është përpiluar lista e pronarëve dhe e sipërfaqeve të cilat do të jenë objekt i shpronësimeve në të ardhmen e cila listë nuk është definitive.
6. Në kuadër të Drejtorisë, sa i përket uzurpimeve, me kërkesë të palëve si dhe sipas detyrës zyrtare kemi dal në teren për identifikimin e uzurpimeve.
7. Ndërrim kulture janë kryer 8 kërkesa
8. Coptim ngastre të Pronës Komunale-zyrtarisht.
9. Shpronësimet të rexhistruar(matje) me kërkesë të drejtorisë.
10. Identifikimi dhe caktimi i kufinjëve në teren.
11. Rirregullim kufiri.
12. Blerja e produkteve (pikave detale) me kërkesë të gjeodetëve të licencuar .
13. Kontrollimin dhe regjistrimin e lëndëve me kërkesë të gjeodetëve të licencuar.
14. Bashkim ngastre.
15. Me Vendimin e Kuvendit Komunal coptim ngastre në teren dhe regjistrimi në pjesën tekstuale dhe grafike.
16. Me Vendimin e Kuvendit Komunal , bashkim dhe coptim ngastre në teren ,për pronat Komunale .
17. Menagjimin e projekteve.
25. Pranimet teknike
- 26.Coptimi i ngastrave komunale dhe regjistrimi i instucioneve publike komunale

Sa i përket zyrës së inspektorit të ndërtimit; gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 17 inspektime me shkrim dhe veprime pasuese si: Procesverbale 17; Aktvendime 12; Aktvendim (gjobë) 5, Aktvendime Rrërimi 4, Incim i procedurës në Gjykatën themelore për Kundërvajtje 3, Incim i procedurës në Prokurorin themelore 2, Përgjigje në kërkesa dhe ankesa 1.

Nr.	Lëndët protokoluara	Lëndë të pranuar	Lëndë të aprovuara	Lëndë të refuzuara	Gjithsej:
1.	Identifikim ngastre ne zyre dhe teren	170	170	/	170
2.	Kontrollimi dhe regjistrimi i lendeve për ndarje të ngastrave etj., nga terreni dhe azhurnimi ne Kadastral Map	174	174		174
3.	Ndërrim kulture	9	9	/	9
4.	Bashkim ngastre	42	42	/	42
6.	Numri i kërkesave nga gjeod. privat për produkte	174	174	/	174
7.	Numri i kërkesave nga gjeod. privat për copëtime	174	174	/	174
8.	Numri i kërkesave në Komunë – copëtime	12	12	/	12
9.	Numri i kërkesave në Komunë per shpronësim	0	0	/	0
10.	Regjistrim i ndarjes ndërtesave-njësive banesore –lokale afaristë (Legalizime)	10 objekte	10 njësi të objekteve	/	10
11.	Shërbime tjera	350	350	/	350
	Tabela e të Hyrave të realizuara në Gjeodezi				8908 Euro

SEKTORI PËR PRONËSI

Gjatë vitit 2025 jemi në procedurë për shpronësimit te Unaza e Vogël rruga '12 Qershori – Wiliam Woker, ku jemi duke pritur nga Ministria e Financave vlerësimin e pronave, kemi në procedurë duke u zhvilluar lidhur me Objektin Afaristo Banesor Para Komunës.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecuresisë së punës për muajt raportues (Janar-Qershor 2025)

Në bazë të planit të punës për vitin 2025, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka paraparë projektet të cilat, si planifikim vjetor i veprimtarisë së saj, bazohen në fushën strategjike të zhvillimit ekonomik.

- Në këtë periudhë është përfunduar faza e dytë e Tregut të Gjelbër, dhe gjithashtu është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për fazën e tretë (III), me të cilën do të finalizohet Tregu i Gjelbër në Shtime.
- Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor ka përfunduar ashtu siç është paraparë, në fshatrat e caktuara. Parashikojmë që edhe për vitin 2026 të parashihet rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavor, me qëllim që bujqve t'u mundësohet qasje më e lehtë në veprimtarinë e tyre.
- Është komisioni për monitorimin e bizneseve, me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë së bizneseve të cilat kanë prona komunale në shfrytëzim.
- Bashkëpunimi me institucione qeveritare dhe joqeveritare për përkrahjen e zhvillimit ekonomik.
- Përfundimi i projektit të kanalizimit në zonën e biznesit në komunën e Shtimes.
- Fillimi i procedurave për rregullimin e rrugës "Idriz Seferi" (faza II).
- Fillimi i punimeve, faza e gjashtë (VI), në Parkun e Pishave në Shtime.

Subvencionet nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZhE)

Është nënshkruar një marrëveshje për bashkëfinancim në bashkëpunim me **UNDP-në**, e cila është duke zbatuar projektin "**Programi i Qëndrueshmërisë Ekonomike**", që ka për qëllim subvencionimin e bizneseve në komunën e Shtimes.

Ky projekt përqendrohet në tri komponentë kryesore të përkrahjes:

1. Ringjalljen e modeleve tradicionale të biznesit;
2. Përmirësimin e prezencës së tyre digjitale;
3. Forcimin e identitetit të tyre komercial;

Këto masa synojnë zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Nga kjo marrëveshje do të përfitojnë **10 biznese**.

Sektori për Zhvillim Ekonomik

Tabela pasqyron aktivitetet e Zyrës për Regjistrimin e bizneseve

Nr	Aktivitetet	Numri
1	Regjistrimi i bizneseve të reja	59
2	Shuarje të biznesit	2
3	Ndryshime në biznes (certifikata të biznesit)	9
4	Certifikata të reja (ndërrime nga certifikata e UNMIK-ut)	0
5	Vërtetim për mos posedim të biznesit	11
6	Ndryshime në biznes (shtim veprimtarie)	17
7	Ndryshime në biznes (shtim, heqje njësie)	6

3	Gjoha	4
4	Inicimi procedurave për Gjykatë	0
5	Konkluzion për Ekzaminimin e Aktvendimit	1
6	Propozim përmbarimi	2